

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më
31 dhjetor 2017
(së bashku me opinionin e audituesit të pavarur)

PËRMBLEDHJE

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE	2
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
1. SUBJEKTI RAPORTUES	5
2. BAZAT E PËRGATITJES	5
3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL	5
4. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIME ENDE TË PA MIRATUARA	12
5. STANDARDET E LËSHURA, DHE EFEKTIVE PËR PERIUDHËN VJETORE	17
6. MENAXHIMI I RREZIKUT	18
(A) RREZIKU I KREDISË	18
(B) RREZIKU I LIKUIDITETIT	26
(C) RREZIKU I TREGUT	30
(D) MENAXHIMI I KAPITALIT	34
7. PËRMBLEDHJE E VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE KONTABËL	34
8. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE PASIVEVE FINANCIARE	37
9. ANALIZA E AKTIVEVE, DETYRIMEVE DHE KAPITALIT SIPAS MATURITETIT	39
10. MJETET MONETARE DHE TE NGJASHME	40
11. HUA DHE PARADHËNIE BANKAVE	40
12. INVESTIME FINANCIARE NË LETRA ME VLERË	40
13. HUA DHE PARADHËNIE DHËNË KLIENTËVE	42
14. QIRA FINANCIARE	43
15. NDËRTEZA DHE PAJISJE	44
16. AKTIVET AFATGJATA JO-MATERIALE	45
17. INVENTARI DHE MJETE TË TJERA	45
18. AKTIVE TË VLEFSHME PËR SHITJE	46
19. INVESTIME NË FILIALE	46
20. DETYRIME NDAJ BANKAVE	46
21. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE	47
22. BORXHI I VARUR	48
23. AKTIVE TATIMORE TË SHTYRA	49
24. PROVIZIONE TË TJERA	49
25. DETYRIME TË TJERA	49
26. KAPITALI AKSIONAR	50
27. REZERVA	50
28. TË ARDHURA NETO NGA INTERESAT	51
29. TË ARDHURA NETO NGA KOMISIONET	51
30. TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE, NETO	51
31. SHPENZIMET E PERSONELIT	51
32. SHPENZIME TË TJERA ADMINISTRATIVE	52
33. TATIM FITIMI	52
34. ANGAZHIME DHE DETYRIMET E KUSHTËZUARA	53
35. ÇËSHTJET LIGJORE	53
36. ANGAZHIMET PËR QIRATË DHE SHPENZIMET PËR QIRATË OPERATIVE	53
37. TRANSAKSIONET E PALËVE TË LIDHURA	54
38. NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT	55

RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Aksionarët e Banka Amerikane e Investimeve sh.a

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Banka Amerikane e Investimeve sh.a (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2017, si dhe pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e flukseve të parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozicionit financiar të Bankës më 31 dhjetor 2017, si dhe të rezultatit të saj financiar dhe të fluksit të mjeteve monetare për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin *Përgjegjësia e Audituesit për auditimin e pasqyrave financiare* të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me *Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël* ("Kodi i BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri ("Kodi IEKA"), dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të Banka Amerikane e Investimeve sh.a. në datën dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, janë audituar nga një auditues tjetër, që ka lëshuar një opinion të pa modifikuar më 30 mars 2017.

Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor të vitit 2017 të Banka Amerikane e Investimeve sh.a

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2017, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të audituesit. Drejtimi është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2017 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të audituesit.

Opinionin ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që Drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Drejtimi është përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e audituesit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Banka Amerikane e Investimeve sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young - Ekspertë Kontabël të Autorizuar
Dega në Shqipëri

Ernst & Young Certified Auditors

3 maj 2018
Tiranë, Shqipëri



Mario Vangjel
Auditues Ligjor

Mario Vangjel

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017 Lekë '000	31 dhjetor 2016 Lekë '000
Aktivet			
Mjetet monetare dhe të ngjashme	10	6,778,201	4,043,274
Hua dhe paradhënie bankave	11	2,718,602	3,100,740
Letra me vlerë të vendosjes	12	10,803,880	10,970,639
Letra me vlerë të investimit	12	7,879,715	6,888,858
Hua dhe paradhënie dhënë klientëve	13	9,285,162	9,263,182
Qira Financiare	14	78,499	-
Aktivet afatgjata materiale	15	528,020	430,041
Aktivet afatgjata jo-materiale	16	157,634	166,937
Të drejta tatimore të shtyra	23	2,226	3,168
Inventari dhe mjete të tjera	17	2,770,739	2,018,997
Aktive të vlefshme për shitje	18	10,075	-
Investim në pjesëmarrje	19	21,250	-
Totali i aktiveve		41,034,003	36,885,836
Detyrimet			
Detyrime ndaj bankave	20	1,056,830	926,609
Detyrime ndaj klientëve	21	34,946,297	31,459,195
Detyrime të tjera	25	286,647	372,601
Provizione	24	29,312	29,481
Detyrime tatimore të shtyra	23	88,650	81,314
Borxhi i varur	22	800,899	1,091,909
Totali i detyrimeve		37,208,635	33,961,109
Kapitali			
Kapitali aksionar	26	7,983,629	7,708,537
Rezerva ligjore	27	57,162	57,162
Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	27	505,230	470,075
Humbja e akumuluar		(4,720,653)	(5,311,047)
Totali kapitalit		3,825,368	2,924,727
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		41,034,003	36,885,836

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5 deri në 55 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E FITIM HUMBJEVE DHE TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHËPËRFSHIRËSE

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2017 Lekë '000	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2016 Lekë '000
Të ardhura nga interesat	1,566,134	1,314,238
Shpenzime për interesa	(404,330)	(443,617)
Të ardhura nga interesat, neto	1,161,804	870,621
Të ardhura nga tarifa dhe komisione	138,060	138,341
Shpenzime për tarifa dhe komisione	(34,994)	(18,270)
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet, neto	103,066	120,071
Rezultati neto nga veprimet me valutat	42,235	41,460
Të ardhura të tjera operative, neto	81,405	13,060
Të ardhura operative	123,640	54,520
Rimarje nga zhvlerësimi i aktiveve financiare, neto	180,285	356,078
Humbje nga zhvlerësimi i zërave jashtë bilancit, neto	(7,748)	(3,083)
Shpenzime personeli	(400,157)	(394,713)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	(105,510)	(101,854)
Shpenzime të tjera administrative	(460,469)	(483,839)
(Shtesë)/Rimarje provizioni për rreziqe dhe shpenzime	(1,236)	2,316
Totali i shpenzimeve	(794,835)	(625,095)
Fitimi neto, përpara tatim fitimit	593,675	420,117
Shpenzimi i tatim fitimit	(3,281)	(716)
Fitimi neto e vitit	590,394	419,401
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		
<i>Zëra që janë ose mund të riklasifikohen në pasqyrën e fitim humbjeve</i>		
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes, neto nga tatimi mbi fitimin	35,155	424,793
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin, neto	35,155	424,793
Totali i të ardhurave të tjera përmbledhëse për vitin, neto	625,549	844,194

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5 deri në 55 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë nënshkruar në emër të Bankës më 3 maj 2018 nga:

Andi Balla
Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv



Armand Muharremi
Drejtori Divizionit të Financës

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

	Kapitali aksionar	Rezerva ligjore	Rezerva për ndryshimet në vlerën e drejtë	Humbja e akumuluar	Totali
	Lekë '000	Lekë '000	Lekë '000	Lekë '000	Lekë '000
Gjendja më 1 janar 2016	7,708,537	57,162	45,282	(5,730,448)	2,080,533
Fitimi i vitit	-	-	-	419,401	419,401
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes, neto	-	-	424,793	-	424,793
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	424,793	419,401	844,194
Veprime me aksionarët, të regjistruara direkt në kapital					
Kontribute të aksionarëve nëpërmjet konvertimit të detyrimeve të varura	-	-	-	-	-
Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	-	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2016	7,708,537	57,162	470,075	(5,311,047)	2,924,727
Fitimi i vitit	-	-	-	590,394	590,394
Ndryshimi në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të vendosjes, neto	-	-	35,155	-	35,155
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse	-	-	35,155	590,394	625,549
Veprime me aksionarët, të regjistruara direkt në kapital					
Kontribute të aksionarëve nëpërmjet konvertimit të detyrimeve të varura (shënimi 22)	275,092	-	-	-	275,092
Totali i kontributeve dhe i shpërndarjeve ndaj aksionarëve	275,092	-	-	-	275,092
Gjendja më 31 dhjetor 2017	7,983,629	57,162	505,230	(4,720,653)	3,825,368

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5 deri në 55 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
	Lekë '000	Lekë '000
Fitimi para tatim fitimit	590,394	419,401
Rregullimet për:		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	15,16	105,510
Fitim nga zhvlerësimi i aktiveve financiare, neto	13,14	(180,285)
Humbje nga zhvlerësimi i zërave jashtë bilancit, neto	24	7,748
Humbje/(fitim) nga zhvlerësimi i provizioneve të tjera operative, neto	24	1,236
Të ardhura neto nga interesat	28	(1,161,804)
Diferenca konvertimi		(13,133)
Nxjerrje jashtë përdorimi e aktiveve afatgjata	15,16	4,665
Shpenzimi i tatim fitimit	34	3,281
Ndryshimet në:		
Hua dhe paradhënie ndaj bankave	11	438,280
Rezervën e detyrueshme	11	(56,142)
Hua dhe paradhënie klientëve	13	82,469
Qera Financiare	14	(78,499)
Detyrimet ndaj bankave	20	130,245
Detyrime ndaj klientëve	21	3,457,229
Inventarë dhe aktive të tjera	17	(751,742)
Aktive të vlefshme për shitje	18	(10,075)
Detyrime të tjera dhe provizione	24,25	(97,443)
Detyrime tatimore të shtyra	23	7,336
Interesi i arkëtuar		1,632,628
Interes i paguar		(377,266)
Fluksi monetar neto nga aktivitetet operative	3,734,632	8,488,228
Fluksi monetar nga aktivitetet investuese		
Investim në pjesëmarrje	19	(21,250)
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	15	(169,674)
Blerje e aktiveve afatgjata jo materiale	16	(29,179)
Ndryshim neto i investimeve në letra me vlerë të vendosjes	12	217,671
Ndryshim neto i investimeve në letra me vlerë të investimit	12	(997,273)
Fluksi monetar neto i përdorur në aktivitetet investuese	(999,705)	(11,650,861)
Fluksi monetar nga aktivitetet financuese		
Të hyra nga rritja e detyrimeve të varura	22	-
Fluksi monetar neto nga aktivitetet financuese	-	-
Rritja/(Zvogëlimi) në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	2,734,927	(3,162,633)
Mjetet monetare dhe ekuivalentë me të më 1 janar	4,043,274	7,205,907
Mjetet monetare dhe ekuivalentë me të më 31 dhjetor	6,778,201	4,043,274

Shënimet shpjeguese të paraqitura në faqet 5 deri në 55 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

1. SUBJEKTI RAPORTUES

Banka Amerikane e Investimeve SHA ("Banka") e njohur më parë si Banka Credit Agricole Shqipëri SHA), është një filial i zotëruar tërësisht nga Tranzit SHPK, një institucion financiar jo-bankar shqiptar i cili ofron disa mundësi fleksibël financimi për shoqëritë dhe individët.

Banka u krijua fillimisht si një degë e Bankës Tregtare të Greqisë (më pas e quajtur Banka Emporiki e Greqisë S.A.) në tetor 1998. Në tetor 1999, Banka, duke u quajtur fillimisht Intercommercial Bank - Albania Sh.A., ishte e autorizuar për të vepruar në të gjitha fushat e aktivitetit bankar. Gjatë vitit 2001 Banka ndryshoi emrin e saj në Bankën Tregtare të Greqisë (Albania) Sh.a. Më 1 mars 2004, emri i Bankës u ndryshua në Emporiki Bank Albania Sh.A.

Në qershor të vitit 2012, Banka Emporiki e Greqisë S.A. i shiti IUB Holding 100% të pjesëmarrjes së saj në filialin e zotëruar 100% të Emporiki Bank Albania sh.a. IUB Holding është një shoqëri anonime Franceze "par actions simplifiée", 100% filial i drejtpërdrejtë i Credit Agricole S.A. Në 3 shtator 2012 emri i bankës ndryshoi në Banka Credit Agricole Shqipëri Sh.A. Në tetor 2015, IUB Holding shiti 100% të pjesëmarrjes 100% në kapitalin aksionar të filialit të saj, Banka Credit Agricole Shqipëri Sh.A, tek Tranzit Sh.p.k. Miratimet e Rregullatorit, duke përfshirë dhe ndryshimin e emrit në Banka Amerikane e Investimeve SHA, u finalizuan me efekt ligjor në datën 12 tetor 2015.

Banka operon në përputhje me Ligjin Nr. 9662 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" të datës 18 dhjetor 2006. Banka është e licënuar për të kryer aktivitetet e kreditimit dhe depozitimit, shërbimet e pagesave në Shqipëri dhe jashtë saj si dhe aktivitetet e tjera bankare në përputhje me ligjet Shqiptare.

Në 31 dhjetor 2017, kapitali i regjistruar aksionar ishte 7,983,629 mijë Lek i përbërë nga 9,998 mijë Euro dhe 6,584,518 mijë Lek (2016: 7,708,537 Lek i përbërë nga 9,998 mijë Euro dhe 6,309,426 mijë Lek) të ndarë në 70,923 aksione të përbërë nga 58,611 aksione me vlerë nominale prej 112,342.71 Lek dhe 12,312 aksione me vlerë nominale prej 812.08 Euro (2016: 68,423 aksione të përbërë nga 56,111 aksione me vlerë nominale prej 112,445.54 Lek dhe 12,312 aksione me vlerë nominale prej 812.08 Euro).

Zyra Qendrore e Bankës është e vendosur në Tiranë në Rrugën e Kavajës, Godina 27 kati 8 hyrja 1. Banka operon vetëm në Shqipëri me një rrjet prej 19 degësh më 31 dhjetor 2017 (2016: 19 degë) Gjashtë degë janë të vendosura në Tiranë dhe degët e tjera janë të vendosura në Durrës, Kavajë Lushnje, Elbasan, Fier, Vlorë Gjirokastrë, Sarandë, Korçë, Lezhë dhe Shkodër, e ndjekur nga 2 agjenci në Portin e Durrësit dhe Livadhja.

Banka ka 248 të punësuar më 31 dhjetor 2017 (2016: 243), nga të cilët 143 (2016: 147) janë të punësuar në Zyrën Qendrore.

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklaratë për përputhshmërinë rregullative

Në përputhje me legjislacionin kontabël vendas, pasqyrat financiare janë përgatitur sipas standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të vendosura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

(b) Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me parimin e kostos historike, me përjashtim të aktiveve financiare të letrave me vlerë të vendosjes , të cilat janë të matura me vlerën e drejtë.

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të raportuara në Lek, e cila është edhe monedha funksionale dhe raportuese e Bankës. Me përjashtim të rasteve të specifikuara, informacioni financiar i shprehur në Lek është rrumbullakosur në të mjtën më të afërt.

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL

Politikat e kontabilitetit janë aplikuar në mënyrë konsistente nga Banka nga viti i kaluar në periudhën aktuale të raportimit. Nga pasqyrat financiare të emetuara në dhe për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2016, ka pasur disa riklasifikime, të përmbledhura si më poshtë:

- Balancat me Bankat me maturim fillestar më pak se 3 muaj janë riklasifikuar nga "Huatë dhe paradhëniet ndaj bankave" në " Mjetet monetare dhe të ngjashme "

- Fondet rezervë për llogaritë rrjedhëse me balanca debitore u riklasifikuan nga "Provizione të tjera" në "Huatë dhe paradhëniet për klientët".

a) Transaksione në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në datën e transaksioneve. Aktivitetet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedhë të huaj në datën e raportimit janë konvertuar në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të vlefshëm në atë datë. Fitimi ose humbja nga kursi i këmbimit mbi zërat monetarë është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës, e rregulluar me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizueshme në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit të fundvitit.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

a) Transaksione në monedhë të huaj (vazhdim)

Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të matura me vlerën e drejtë në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e përcaktimit të vlerës së drejtë. Aktivitet dhe detyrimet jo-monetare të matura me koston historike në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Diferencat nga kurset e këmbimit në përgjithësi njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Kurset zyrtare të këmbimit për monedhat e huaja kryesore të përdorura në konvertimin e gjëndjeve të bilancit në monedhë të huaj në 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë si më poshtë (në LEK):

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
1 USD	111.10	128.17
1 EUR	132.95	135.23
1 GBP	149.95	157.56

b) Interesat

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në fitim ose humbje me anë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton saktësisht pagesat dhe arkëtimet të pritshme në të ardhmen përgjatë jetëgjatësisë së pritshme të aktivitet ose detyrimit financiar (ose, kur është e përshtatshme, për një periudhë më të shkurtër) në vlerën kontabël të aktivitet ose detyrimit financiar. Për llogaritjen e normës efektive të interesit, Banka vlerëson rrjedhën e parasë në të ardhme duke marrë në konsideratë të gjitha kushtet kontraktuale të instrumenteve financiare, por jo humbjet nga kredia në të ardhmen.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha tarifat e paguara ose të marra që janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit përfshijnë shpenzime shtesë të lidhura drejtpërdrejtë me blerjen ose emetimin e një aktivi ose detyrimi financiar.

c) Tarifat dhe komisionet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit të një aktivi ose detyrimi financiar përfshihen në përcaktimin e normës efektive të interesit.

Të ardhura dhe shpenzime të tjera nga tarifa dhe komisione lindin nga shërbime financiare të kyera nga Banka dhe njihen në momentin kur shërbimi respektiv është ofruar ose përfutur.

d) Shpenzime për tatimet

Shpenzimet për tatimin mbi fitimin përfshijnë tatimin afatshkurtër dhe tatimin e shtyrë. Tatimi afatshkurtër dhe tatimi i shtyrë njihen në pasqyrën e të ardhurave me përjashtim kur i referohet zërave të cilët njihen direkt në kapital ose tek të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet ose të arkëtohet për të ardhurat e tatueshme ose shpenzimet për periudhën, dhe çdo rregullim të tatimit që duhet të paguhet ose të arkëtohet në lidhje me vitet e mëparshme. Shuma e tatimit aktual e pagueshme ose e arkëtueshme është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose të arkëtohet që reflekton pasiguri lidhur me tatimet mbi të ardhurat, nëse ka. Ajo matet duke përdorur normën tatimore në fuqi ose të miratuar parimisht në datën e raportimit.

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë përlogaritet mbi diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të mbetur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Tatimi i shtyrë nuk njihet për diferencat e përkohshme në njohjen fillestare të aktiveve ose detyrimeve në një transaksion që nuk është kombinim biznesi dhe nuk ndikon as në kontabilitet as në fitimin ose humbjen e tatueshme.

Aktivitet tatimore të shtyra njihen mbi humbjet tatimore të mbartura, të drejtat tatimore të mbartura dhe diferencat e përkohshme të zbritshme duke konsideruar fitime të ardhshme të tatueshme, kundrejt të cilave të mund të përdoren. Aktivitet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë raportimi dhe zvogëlohen në masën që nuk është më i mundur realizimi i përfuturimit tatimor respektiv; reduktimet e tilla sistemohen, kur probabiliteti i fitimit të tatueshëm në të ardhmen përmirësohet. Më 31 dhjetor 2017 Banka ka humbje tatimore të papërdorura prej 28,409 mijë lekësh, të cilat skadojnë më 31 dhjetor 2019. Këto humbje megjithatë janë përdorur kundrejt fitimit tatimor të vitit aktual.

Aktivitet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën e fitimit të ardhshëm të tatueshëm që do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit ato mund të përdoren.

Tatimi i shtyrë llogaritet me normat tatimore që priten të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme në momentin e rimarrjes, duke përdorur normat tatimore në fuqi ose që hyjnë në fuqi në datën e raportimit.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

e) Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja dhe matja fillestare

Banka fillimisht njihet huatë dhe paradhëniet, depozitat, letrat me vlerë të borxhit, të emetuara dhe detyrimet e varura në datën kur ato janë krijuar. Blerjet dhe shitjet e rregullta të aktiveve financiare njihen në datën e tregtimit kur banka angazhohet për blerjen ose shitjen e aktivit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e tjera financiare njihen fillimisht në datën e tregtimit në të cilën Banka bëhet palë për respektimin e dispozitave kontraktuale të instrumentit. Aktivi ose detyrimi financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot e transaksionit të cilat lidhen direkt me blerjen ose emetimin e tij.

(ii) Klasifikimi

Aktivitetet financiare

Banka i klasifikon aktivet e saj financiare në një nga kategoritë e mëposhtme:

- Hua dhe të arkëtueshme;
- Të mbajtura deri në maturim; ose
- Të vlefshme për shitje.

Shikoni politikat kontabël 3 (h dhe i)

Detyrimet financiare

Banka i klasifikon detyrimet e saj financiare, përveç si garanci financiare dhe angazhime të huasë, si të matura me koston e amortizuar. Shikoni politikat kontabël 3.n.

(iii) Çregjistrimi

Aktivitetet financiare

Banka çregjistron një aktiv financiar nëse të drejtat kontraktuale mbi flukset monetare nga aktiviteti financiar mbarojnë ose kur transferon të drejtat për të përfituar flukset monetare kontraktuale nga aktiviteti financiar me një transaksion nëpërmjet të cilit transferohen në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivitetit financiar. Çdo interes në aktivet financiare të transferuara që krijohet ose mbahet nga Banka njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Banka kryen transaksione nëpërmjet të cilave transferon aktivet e njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha ose në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet janë mbajtur, atëherë aktivet e transferuara nuk çregjistrohen. Transferime të aktiveve për të cilat mbahen një pjesë e mirë ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshijnë huadhënien e letrave me vlerë dhe marrëveshjet e riblerjes. Përsa i përket transaksioneve ku Banka nuk mban dhe as transferon në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet që rrjedhin nga pronësia mbi aktivin financiar, ajo e çregjistron aktivin kur nuk mban kontrollin mbi të. Të drejtat dhe detyrimet të cilat mbahen gjatë transferimit njihen veçmas si aktive dhe si detyrime, sipas rastit. Në transferime, ku ruhet kontrolli mbi aktivin, Banka vazhdon të njohë aktivin në masën e përfshirjes së vazhdueshme, e përcaktuar nga masa në të cilën ajo është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar.

Në disa transaksione Banka ruan detyrimin të shërbejë ndaj aktivitetit financiar të transferuar kundrejt një komisioni. Aktivi i transferuar çregjistrohet në tërësi nëse plotësohen kriteret e çregjistrimit. Një aktiv ose detyrim njihet kundrejt kontratës së shërbimit, në varësi të faktit nëse tarifa e shërbimit, për kryerjen e shërbimit është më shumë se mjaftueshëm (aktiv) ose është më pak se mjaftueshëm (detyrim). Banka fshin kredi të caktuara - kur ato konsiderohen si të pambledhshme (shikoni notën 6.a).

Detyrimet financiare

Banka çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale të tij janë shfuqizuar, anuluar ose kur ju ka mbaruar afati.

(iv) Kompensimi

Aktivitetet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe vlera neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Banka gëzon të drejtën ligjore për të bërë kompensimin e vlerave, dhe ka si qëllim ose të shlyejë mbi një bazë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten neto vetëm nëse lejohen nga standardet e kontabilitetit, ose për fitime apo humbje të cilat rezultojnë nga realizimi i një grupi transaksionesh të ngjashme në aktivitetin tregtar të Bankës.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kosto e amortizueshme e aktivitetit ose detyrimit financiar është shuma me të cilën aktiviteti dhe detyrimi financiar matet në fazën e njohjes fillestare minus pagesat e principalit, minus ose plus vlerën e amortizimit të akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo ndryshim midis shumës fillestare që është njohur dhe shumës në maturim, minus çdo humbje nga zhvlerësimi.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

e) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(vi) Matja me vlerën e drejtë

Vlera e drejtë është çmimi që do të merrej për të shitur një aktiv ose paguhej për të transferuar një detyrim, në një transaksion të zakonshëm ndërmjet palëve pjesëmarrëse të tregut në datën e matjes, në tregun kryesor ose, në mungesë të tij, në tregun më të favorshëm në të cilin Banka ka akses në këtë datë. Vlera e drejtë e një detyrimi pasqyron rrezikun e mos-performancës së tij.

Kur janë të disponueshme, Banka mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmime të publikuara në një treg aktiv për instrumentin. Një treg konsiderohet aktiv nëse transaksionet mbi aktivet dhe detyrimet kanë frekuencë dhe vlera të mjaftueshme për të siguruar informacion mbi çmimet e kuotuar të tregut në mënyrë të vazhdueshme. Nëse nuk ekziston një çmim i kuotuar në një treg aktiv, atëherë Banka përdor teknika vlerësimi që maksimizojnë përdorimin e të dhënave të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e të dhënave të paverifikueshme. Teknika e zgjedhur e vlerësimit konsideron të gjithë faktorët që aktorët e tregut do të konsideronin në vendosjen e çmimit.

Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në momentin e njohjes fillestare është çmimi i transaksionit, pra vlera e drejtë e shumës së marrë apo dhënë. Nëse Banka përcakton se vlera e drejtë në momentin e njohjes fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe nuk është përcaktuar as duke përdorur një çmim të kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv të ngjashëm as nuk bazohet në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregje të mbikëqyrura, atëherë instrumenti financiar matet fillimisht me vlerën e drejtë, rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në momentin e njohjes fillestare dhe çmimit të transaksionit. Më pas, kjo do të njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme përgjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se momenti kur vlerësimi mbështetet plotësisht në të dhëna të identifikueshme të tregut apo transaksioni mbyllet.

Aktivitet dhe pozicionet e gjata në blerje maten me çmimin ofertë; detyrimet dhe pozicionet e shkurtra në shitje maten me çmim kërkesë.

Vlera e drejtë e një depozite pa afat nuk është më pak se shumta e pagueshme sipas kërkesës, skontuar nga data e parë në të cilën do të mund të kërkohej shumta për t'u paguar.

Banka njeh transferimet ndërmjet niveleve të hierarkisë së vlerës së drejtë në fund të periudhës raportuese në të cilën ka ndodhur ndryshimi.

(vii) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka fakte objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara. Aktivet financiare ose një grup i aktiveve financiare zhvlerësohen kur faktet objektive tregojnë që një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe që kjo ngjarje humbjeje ka një ndikim në flukset e ardhshme monetare nga ky aktiv që mund të vlerësohen në mënyrë të besueshme.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë zhvlerësuar mund të përfshijnë mospërbushje e detyrimeve ose shkelje të detyrimeve nga huamarrësi, rristurimin e një huaje ose paradhënje nga Banka me kushte që në të kundërt Banka nuk do të konsideronte treguesit që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, humbjen e një tregu aktiv të letrave me vlerë, ose të dhëna të tjera në lidhje me një grup aktivesh si ndryshimet jo të favorshme në statusin e pagesës së huamarrësve dhe emetuesve në grup, ose kushtet ekonomike të cilat lidhen me mospërbushjen e detyrimeve në grup.

Banka konsideron evidencën për zhvlerësimin e kredive dhe paradhënjeve si në nivel individual ashtu edhe në nivel grupi. Të gjitha kreditë individualisht të rëndësishme vlerësohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha kreditë dhe paradhëniet individualisht të rëndësishme, por jo të zhvlerësuara në mënyrë specifike, vlerësohen në grup për çdo zhvlerësim të ndodhur, por të paidentifikuar ende. Kreditë dhe paradhëniet, të cilat nuk janë individualisht të rëndësishme, vlerësohen në grup për zhvlerësim, duke grupuar së bashku investime në letra me vlerë të kredive dhe paradhënjeve me karakteristika të ngjashme rreziku.

Në përcaktimin e zhvlerësimit në nivel grupi Banka aplikon si minimum trendet historike të normave rregullatore të paracaktuara, kohën e rekuperimit dhe shumën e humbjeve të ndodhura për secilin grup homogjen të huave dhe paradhënjeve bazuar në fakte objektive të zhvlerësimit. Normat e paracaktuara dhe periudha e pritshme e rekuperimeve të ardhshme krahasohen rregullisht me rezultatet aktuale për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme.

Humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar, maten si diferencë midis vlerës kontabël të aktivit financiar dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të ardhshme, të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në fitim ose humbje dhe pasqyrohen në një llogari zbritje kundrejt kredive, parapagimeve ose investimeve në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim. Kur një ngjarje e evidentuar pas njohjes së zhvlerësimit shkakton uljen e vlerës së zhvlerësimit, ulja në humbjen nga zhvlerësimi rimerret nëpërmjet fitimit dhe humbjes.

Humbje nga zhvlerësimi investimeve në letra me vlerë të vlefshme për shitje, nëse ka, njihen duke ri-klasifikuar humbjet e akumuluar nga rezerva e vlerës së drejtë nga llogaritë e kapitali në fitim dhe humbje. Humbja e akumuluar e ri-klasifikuar nga kapitali në fitim ose humbje, është diferenca midis kostos së blerjes, neto nga ndonjë pagesë kryesore apo amortizimi, dhe vlerës së drejtë aktuale, të pakësuar për humbje nga zhvlerësime të njohura më parë në fitim ose humbje.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

e) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

(VII) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimeve (vazhdim)

Ndryshime në provizionet për zhvlerësim që lidhen me aplikimin e normës efektive të interesit paraqiten si pjesë e të ardhurës nga interesi. Nëse në një periudhë pasuese, vlera e drejtë e një letre me vlerë të vlefshme për shitje, të zhvlerësuar, rritet, dhe kjo rritje mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi, atëherë humbja nga zhvlerësimi rimeret nëpërmjet llogarisë së rimarjes në fitim humbje. Sidoqoftë, çdo rikuperim i mëtejshëm në vlerën e drejtë të një letre me vlerë kapitali, të vlefshme për shitje, të zhvlerësuar njihet në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

f) Mjete monetare dhe të ngjashme

Mjete monetare dhe ekuivalente me to përfshijnë mjetet në arkë, llogaritë me Bankën Qendrore, investime afatshkurtra shumë likuide me maturitet fillestar 3 muaj ose më pak nga data e blerjes që janë subjekt i një rreziku të papërfillshëm të ndryshimeve në vlerën e drejtë, dhe përdoren nga Banka në administrimin e angazhimeve afatshkurtra.

g) Hua dhe paradhënie dhënë klientëve

Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv dhe Banka nuk ka për qëllim shitjen e tyre të menjëhershme ose në një kohë të afërt.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje ri-shitjeje të aktivit (ose të aktiveve të ngjashme) me një çmim fiks në një datë të ardhshme ("marrëveshje e anasjelltë ri-blerjeje" ose "huamarrje aksionesh"), marrëveshja kontabilizohet si kredi ose paradhënie dhe aktivi në fjalë nuk njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet maten fillimisht me vlerën e drejtë plus kostot shtesë direkte me transaksionin dhe më pas maten me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

h) Qiraja financiare

Banka si qiramarrëse - Pagesat operative të qirasë

Përcaktimi nëse një marrëveshje është një kontratë qiraje ose përmban një kontratë qiraje, bazohet në thelbin e marrëveshjes dhe kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes varet nga përdorimi i një aktivi ose pasurie të caktuar dhe marrëveshja përcjell të drejtën për të përdorur asetin. Qiratë që nuk transferojnë në Bankë në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e sendeve të dhëna me qira janë qiratë operative. Pagesat e bëra sipas qirasë operative njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në baza lineare gjatë periudhës së qirasë. Inisiativat e qerasë janë njohur si pjesë përbërëse e shpenzimit total të qirasë, gjatë afatit të qirasë.

Banka si qiradhënëse

Qiratë në të cilat Banka transferon kryesisht të gjithë rrezikun dhe përfitimet nga pronësia e aktivit klasifikohen si qira financiare. Në pasqyrën e pozicionit financiar Banka paraqet shumën e arkëtueshme të barabartë me vlerën e investimit neto. Njohja e të ardhurave financiare duhet të bazohet në një model që pasqyron një normë periodike konstante të kthimit të investimit neto të qiradhënësit në qiranë financiare. Pagesat e qirasë për periudhën, pa përfshirë kostot për shërbime, aplikohen kundrejt investimit bruto në qira, për të reduktuar si principalin ashtu edhe të ardhurat e pafituara të financimit.

Të ardhurat e shitjeve të njohura në fillimin e afatit të qirasë nga një prodhues ose qiradhënës janë vlera e drejtë e aktivit ose, nëse është më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të qirasë që rrjedhin nga qiradhënësi, të llogaritura me një normë tregu të interesit.

i) Kontratat e garancisë financiare

Kontratat e garancisë financiare të lëshuara nga Banka janë ato kontrata që kërkojnë që të bëhet pagesa për të rimbursuar mbajtësin e garancisë për një humbje që lind për shkak se debitori nuk arrin të bëjë një pagesë në kohën e duhur në përputhje me kushtet e një instrumenti borxhi. Kontratat e garancisë financiare njihen fillimisht si një pasiv me vlerë të drejtë, të rregulluar për kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejtë dhënies së garancisë. Më pas, detyrimi matet në vlerën më të lartë të vlerësimit më të mirë të shpenzimeve të kërkuara për të shlyer detyrimin aktual në datën e raportimit dhe vlerës së njohur pas zbritjes së amortizimit të akumuluar.

j) Investime në Letra me Vlerë

Investimet në letra me vlerë njihen në fillim me vlerën e drejtë plus kostot shtesë direkte të lidhura me transaksionin, dhe më pas kontabilizohen në varësi të klasifikimit të tyre si: të investimit ose të vendosjes.

(i) Letra me vlerë të investimit

Letra me vlerë të investimit janë aktive financiare jo derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara dhe me maturitete fikse që Banka ka qëllimin dhe mundësinë t'i mbajë deri në maturim dhe që nuk klasifikohen si të gatshme për shitje. Investimet e mbajtura deri në maturim maten me koston e amortizuar nëpërmjet metodës së interesit efektiv.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

j) Investime në Letra me Vlerë (vazhdim)

(i) Letra me vlerë të investimit (vazhdim)

Çdo shitje apo riklasifikim i një shume të rëndësishme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo afër maturimit të tyre, do të rezultonte në riklasifikimin e instrumentave të mbajtur deri në maturim si të vlefshme për shitje dhe do ta ndalonte Bankën t'i klasifikojë ato si investime në letra me vlerë të mbajtura deri në maturim për vitin ushtrimor aktual dhe dy vitet ushtrimore të ardhshëm.

(ii) Letra me vlerë të vendosjes

Letra me vlerë të vendosjes janë instrumente jo derivative të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Letrat me vlerë të pakuotuar të kapitalit, vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, mbahen me kosto. Të gjitha investimet e tjera të vlefshme për shitje mbarten me vlerën e drejtë.

Të ardhurat nga interesi njihen në fitim ose humbje duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet ose humbjet nga kursi i këmbimit të investimeve në letra me vlerë të borxhit të vlefshme për shitje njihen në fitim ose humbje. Ndryshime të tjera të vlerës së drejtë njihen drejtpërdrejtë në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse deri kur investimi të jetë shitur ose zhvlerësuar dhe fitimi ose humbja e akumuluar e njohur më përpara në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, riklasifikohet në fitim ose humbje.

Investimet e vlefshme për shitje mund të riklasifikohen nga kategoria të vlefshme për shitje, në kategorinë të mbajtura deri në maturim në qoftë se plotësojnë përkufizimin si të mbajtura deri në maturim dhe nëse banka ka synimin dhe aftësinë për të mbajtur atë aktiv financiar për një të ardhme të parashikueshme, ose deri në maturim.

k) Aktivët Afatgjatë Material

(i) Njohja dhe matja

Aktivët afatgjatë materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë të gjitha shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejtë me blerjen e aktivit. Nëse pjesë të një aktivit afatgjatë material kanë jetë të dobishme të ndryshme, atëherë këto pjesë kontabilizohen si zëra të veçanta (përbërësit kryesor) të aktiveve afatgjatë materiale. Çdo fitim ose humbje nga shitja/nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivit afatgjatë material (të llogaritur si diferenca midis të ardhurave neto nga shitja e aktivit dhe vlera kontabël të aktivit) njihet tek të ardhurat e tjera në fitim ose humbje.

(ii) Kosto të tjera pasuese

Kostot e zëvendësimit të një pjese të aktivit afatgjatë material njihen me vlerën kontabël të aktivit nëse është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike që lidhen me këtë aktiv do të rrjedhin për Bankën dhe nëse kostot e tij mund të maten në mënyrë të besueshme.

(iii) Amortizimi

Zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material. Trualli dhe veprat e artit nuk zhvlerësohen. Jeta e dobishme e vlerësuar për periudhën aktuale janë të paraqitura si më poshtë:

	(në vite)
• Ndërtesa	40
• Mobilje dhe pajisje zyre	5
• Automjete	5
• Përmirësimet e ambienteve të marra me qira	9 - 12
• Kompjuterat dhe pajisjet elektronike	4 - 5

Aktivët nuk amortizohen deri në momentin që fillojnë të përdoren dhe transferohen nga aktive në ndërtim apo zhvillim, në kategorinë përkatëse të aktiveve.

l) Aktivët afatgjatë jomateriale

Aktivët afatgjatë jomateriale paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi. Amortizimi llogaritet duke përdorur metodën lineare përgjatë jetës së dobishme të vlerësuar të aktivit. Jeta e dobishme e vlerësuar paraqitet si më poshtë:

	(në vite)
• Programe dhe aplikacione të teknologjisë informative	4 - 10

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

3. POLITIKAT KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

m) Inventari i aktiveve të marra në zotërim

Inventari përfshin aktivet e marra në zotërim nëpërmjet ekzekutimit të garancisë mbi kreditë me probleme dhe paradhëniet ndaj klientëve, të cilat, nuk janë dhënë me qira, nuk janë në përdorim nga Banka dhe janë planifikuar të shiten brenda një periudhe të shkurtër të arsyeshme, pa qenë objekt ristrukturimi të rëndësishëm. Aktivet e marra në zotërim maten me vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme si dhe të gjitha fshirjet e inventarit paraqiten në fitim ose humbje.

n) Zhvlerësimi i aktiveve jo financiare

Vlera kontabël e mbetur e aktiveve jo financiare të Bankës, të ndryshme nga aktivet tatimore të shtyra dhe inventarët, rishikohet çdo datë raportimi, për të përcaktuar nëse ka tregues të zhvlerësimit. Nëse ka tregues të tillë atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit. Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur kontabël e aktivit ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme të aktivit. Një njësi gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve i cili gjeneron flukse monetare, të cilat në masë të madhe janë të pavarura nga aktivet e tjera ose grupet e tjera të aktiveve. Humbjet nga zhvlerësimi janë njohur në fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimi të njohura në lidhje me njësitë gjeneruese të mjeteve monetare alokohen fillimisht për të pakësuar vlerën kontabël të emrit të mirë të alokuar kësaj njësie gjeneruese të mjeteve monetare dhe më pas për të ulur vlerën kontabël të aktiveve të tjera të njësisë gjeneruese të mjeteve monetare (grup njësisish gjeneruese të mjeteve monetare), me bazë të ponderuar. Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është më e madhja midis vlerës së tij në përdorim dhe vlerës së drejtë minus kostot e shitjes. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e vlerësuar monetare të ardhshme janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

o) Depozitat, hua dhe paradhënie nga bankat dhe detyrime të tjera financiare

Depozitat përbëjnë burimet kryesore të financimit të Bankës. Kur Banka shet një aktiv financiar dhe në të njëjtën kohë nënshkruan një marrëveshje për riblerjen e aktivit (ose të një aktivi të ngjashëm) me çmim fiks në një datë të ardhshme ("repo" ose "huamarrje aktive") marrëveshja kontabilizohet si depozitë, dhe aktivi në fjalë vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentat e kapitalit si detyrime financiare ose instrumente kapitali në përputhje me kushtet kontraktuale të instrumentit. Depozitat dhe detyrimet e varura fillimisht maten me vlerën e drejtë plus kostot shtesë direkte të transaksionit, dhe më pas maten me koston e tyre të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, me përjashtim kur Banka vendos të mbart detyrimet me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

p) Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje në të kaluarën, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv dhe ka të ngjarë të ketë një dalje të burimeve ekonomike për shlyerjen e detyrimit. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme monetare me një normë para tatimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe aty ku është e përshtatshme, edhe rreziqe specifike të detyrimit.

q) Përfitimet e punonjësve

Banka paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore të cilat përfitohen nga punonjësit pas daljes në pension. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributesh të përcaktuara. Kontributet e Bankës për planin e pensionit ngarkohen në fitim ose humbje në momentin kur ato ndodhin.

r) Investimet në filiale

Investimi në një pjesëmarrje është një entitet mbi të cilin Shoqëria ka ndikim të rëndësishëm. Ndikim i rëndësishëm është fuqia për të marrë pjesë në vendimet e politikës financiare dhe operative të të investuarit, por nuk është kontroll ose kontroll i përbashkët mbi këto politika.

Konsideratat e bëra në përcaktimin e ndikimit të rëndësishëm ose të kontrollit të përbashkët janë të ngjashme me ato të domosdoshme për të përcaktuar kontrollin mbi filialet. Investimi i Bankës në shoqërinë e tij llogaritet me kosto. Investimi kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto në pasqyrat financiare të konsoliduara të shoqërisë mëmë të bankës, dmth. Transzit shpk.

Pas humbjes së ndikimit të rëndësishëm mbi pjesëmarrjen, Banka mat dhe njeh çdo investim të mbartur në vlerën e tij të drejtë. Çdo diferencë midis vlerës kontabël neto të pjesëmarrjes pas humbjes së ndikimit të rëndësishëm dhe vlerës së drejtë të investimit të mbartur dhe të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit njihen në fitim ose humbje.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIME ENDE TË PA MIRATUARA

Standardet dhe interpretimet që janë lëshuar, por që nuk janë ende efektive, deri në datën e nxjerrjes së pasqyrave financiare të Bankës janë dhënë më poshtë. Banka synon të miratojë këto standarde, nëse është e aplikueshme, kur ato të hyjnë në fuqi.

• SNRF 9 Instrumentet Financiare

Prezantim

Në korrik 2014, BSNK lëshoi SNRF 9 Instrumentet Financiare, standardi që do të zëvendësojë SNK 39 për periudhat vjetore më ose pas 1 janarit 2018, me lejimin e adoptimit të hershëm. Banka krijoi një ekip zbatues multidisiplinar ('Ekipi') me anëtarët e divizioneve të saj të Riskut, Financave, IT dhe Administrimit të Kredive për t'u përgatitur për zbatimin e SNRF 9 ('Projekti'). Projekti drejtohet nga Drejtorët e divizioneve të Riskut dhe të Financës dhe menaxhohet brenda kornizës së transformimit të Bankës. Projekti ka një rrjedhë të qartë pune dhe Banka ka përfutur një softuer specifik për të mbështetur një llogaritje të automatizuar të dispozitave të SNRF 9. Përfundimi i projektit dhe vënia në funksionim e softuerit parashikohen brenda gjysmës së parë të vitit 2018. Faza fillestare e vlerësimit dhe analizës u përfundua gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017. Fazat e analizës dhe projektimit kanë përfunduar tashmë për klasifikimin, matjen dhe zhvlerësimin, si dhe për kërkesat përkatëse të paraqitjes.

Klasifikimi dhe matja

Nga pikëpamja e klasifikimit dhe matjes, standardi i ri do të kërkojë që të gjitha aktivet financiare, përveç instrumentave të kapitalit dhe derivativëve, të vlerësohen në bazë të një kombinimi të modelit të biznesit të njësishë ekonomike për menaxhimin e aktiveve dhe karakteristikat e flukseve monetare kontraktuale të instrumentave. Kategoritë e matjes së SNK 39 do të zëvendësohen nga: Vlera e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVPL), vlera e drejtë nëpërmjet të ardhurave të tjera përmbledhëse (FVOCI), dhe kostoja e amortizuar. SNRF 9 do të lejojë gjithashtu që njësitet ekonomike të vazhdojnë të përcaktojnë instrumentet që kualifikohen për koston e amortizuar ose vlerën e drejtë nëpërmjet instrumenteve të OCI si FVPL, nëse kjo eliminon ose zvogëlon në mënyrë të konsiderueshme paqëndrueshmërinë e matjes ose të njohjes. Instrumentet e kapitalit që nuk mbahen për shitje mund të përcaktohen në mënyrë të pakthyeshme si FVOCI, pa riklasifikim të mëvonshëm të fitimeve ose humbjeve në pasqyrën e të ardhurave.

Kontabilizimi i detyrimeve financiare do të jetë kryesisht i njëjtë me kërkesat e SNK 39, përveç trajtimit të fitimeve ose humbjeve që lindin nga rreziku i kreditit të një njësie ekonomike që lidhet me detyrimet e përcaktuara në FVPL. Lëvizje të tilla do të paraqiten në OCI pa riklasifikim të mëvonshëm në pasqyrën e të ardhurave, përveç rasteve kur mund të lindë një mospërputhje kontabël në fitim ose humbje.

Pas përfundimit të vlerësimit fillestar, Banka ka konstatuar se:

- Shumica e huave dhe paradhënive për bankat, huatë dhe paradhëniet për klientët, cash kolaterali për marrëveshjet e riblerjes dhe balancat rregulluese të Cash-it me shtëpitë e kliringut që klasifikohen si hua dhe llogari të arkëtueshme sipas SNK 39 pritet të maten me koston e amortizuar sipas SNRF 9.
- Shumica e titujve të borxhit të klasifikuar si letra me vlerë të vendosjes sipas SNK 39 pritet të maten në FVOCI. Disa letra me vlerë, megjithatë, do të klasifikohen si FVPL, ose për shkak të karakteristikave të tyre kontraktuale të flukseve të parasë ose për shkak të modelit të biznesit brenda të cilit ata mbahen.
- Letrat me vlerë të borxhit të klasifikuara si letra me vlerë të investimit pritet të vazhdojnë të maten me koston e amortizuar.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Përmbledhje

SNRF 9 gjithashtu do të ndryshojë rrënjësisht metodologjinë e zhvlerësimit të humbjes së kredisë. Standardi do të zëvendësojë metodën e humbjeve të ndodhura të SNK 39 me një metodë humbjeje të pritshme (ECL). Bankës do t'i kërkohej të regjistrojë një provigjon për humbjet e pritshme për të gjitha huatë dhe aktivet e tjera financiare të borxhit që nuk mbahen në FVPL, së bashku me angazhimet e huasë dhe kontratat e garancisë financiare. Provigjoni bazohet në humbjet e pritura të kredisë të lidhura me probabilitetin e dështimit në dymbëdhjetë muajt e ardhshëm, përveç rasteve kur ka pasur një rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë që nga krijimi, rast në të cilin, provigjoni bazohet në probabilitetin e dështimit gjatë jetës së aktivit.

Banka ka vendosur një politikë për të kryer një vlerësim në fund të çdo tremujori të periudhës raportuese nëse rreziku i kredisë është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare duke marrë parasysh ndryshimin në rrezikun e dështimit që ndodhin gjatë jetës së mbetur të instrumentit financiar.

Për të llogaritur ECL, Banka do të vlerësojë rrezikun e një humbjeje të mundshme që ndodh gjatë jetës së pritshme të një instrumenti financiar. ECL-të vlerësohen bazuar në vlerën aktuale të të gjitha humbjeve të mjeteve monetare gjatë jetës së mbetur të aktivit financiar, dmth, diferenca ndërmjet: flukseve të mjeteve monetare kontraktuale që Banka duhet të marrë sipas kontratës dhe flukseve të mjeteve monetare që Banka pret të marrë, të skontuara me normën efektive të interesit të huasë.

Në krahasim me SNK 39, Banka pret që provizionet sipas SNRF 9 të pasqyrojnë paqëndrueshmëri të ngjashme me SNK 39 dhe, megjithatë, të mos rezultojë në një rritje në nivelin e përgjithshëm të provizioneve aktuale.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIME ENDE TË PA MIRATUARA (VAZHDIM)

•SNRF 9 Instrumentet Financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Banka i grupon kreditë e veta në Fazën 1, Fazën 2 dhe Fazën 3, bazuar në metodologjinë e aplikuar të provigjionimit, siç përshkruhet më poshtë:

- Fazë 1 - Kreditë performuese: kur kreditë njihen fillimisht, Banka njih një provigjon bazuar në humbjet e pritshme 12-mujore të kredisë.
- Fazë 2 - Kreditë jo-performuese: kur një hua tregon një ndjeshmëri më të lartë ose një rritje të ndjeshme në rrezikun e saj të kredisë, Banka regjistron një provigjon për humbjen e pritshme gjatë gjithë jetës të kredisë.
- Fazë 3 – Kredi të zhvlerësuar: Banka njih humbjet e pritshme gjatë gjithë jetës të kredisë për këto kredi.

Përveç kësaj, në Fazën 3 Banka përllogarit të ardhura nga interesi për koston e amortizuar të huasë neto nga provigjonet.

Banka do të regjistrojë provigjone për letrat me vlerë të borxhit të FVOCI, në varësi të faktit nëse ato klasifikohen si Fazë 1, 2 ose 3, siç u shpjegua më sipër. Megjithatë, humbjet e pritshme të kredisë nuk do të zvogëlojnë vlerën kontabël të këtyre aktiveve financiare në pasqyrën e pozicionit financiar, i cili do të mbetet me vlerën e drejtë. Në vend të kësaj, një shumë e barabartë me kompensimin që do të lindte nëse aktivi do të matet me koston e amortizuar do të njihet në OCI si një shumë e zhvlerësuar e akumuluar, me një shtesë korresponduese në fitim ose humbje.

Për letrat me vlerë me "rrezik të ulët", Banka synon të zbatojë një politikë që supozon që rreziku i kredisë në instrument nuk është rritur ndjeshëm që nga njohja fillestare dhe do të llogarisë ECL siç shpjegohet në Fazën 1 më poshtë. Instrumentet e tilla në përgjithësi do të përfshijnë Qeverinë Shqiptare dhe letrat me vlerë të investimit. Supozimet kryesore nënkuptojnë se huamarrësi nuk ka të dhëna historike për mospërbushje të detyrimeve dhe ka një kapacitet të fortë për të përmbushur detyrimet kontraktuale të flukseve monetare në afat të afërt. Përveç kësaj, çdo ndryshim i pafavorshëm në kushtet ekonomike dhe të biznesit në afat më të gjatë, mund të zvogëlojë, por jo domosdoshmërisht, aftësinë e huamarrësit për të përmbushur detyrimet kontraktuale të flukseve monetare.

Banka nuk do të konsiderojë instrumente me rrezik të ulët të kredisë thjesht për shkak të vlerës së kolateralit. Instrumentet financiare gjithashtu nuk konsiderohen të kenë rrezik të ulët të kredisë thjesht për shkak se ato kanë një rrezik më të ulët të vonësës sesa instrumentet e tjera financiare të Bankës.

Faza 1

Sipas SNK 39, Banka ka regjistruar një provigjon për humbjet nga zhvlerësimi i shkaktuar, por jo i identifikuar (IBNI). Këto provigjone janë projektuar për të pasqyruar humbjet nga zhvlerësimi që kanë ndodhur në portofolin e kredive performuese por nuk janë identifikuar. Sipas SNRF 9, zhvlerësimi i aktiveve financiare që nuk konsiderohen se kanë pësuar një rritje të konsiderueshme në rrezikun e tyre të kredisë do të matet në bazë të ECL 12 muajsh. Në krahasim me zhvlerësimin kolektiv siç shpjegohet më tej në shënimin për Menaxhimin e Riskut, shuma e provigjionit bazuar në ECL 12 muajsh pritet të jetë në nivele të ngjashme ose më të ulëta se provigjoni aktual për IBNI. Bazuar në analizën e kryer, provigjoni bazuar në ECL 12-mujor i llogaritur në portofolin e vitit 2017 do të ishte më i ulët se provigjoni për IBNI sipas SNK 39.

Faza 2

SNRF 9 kërkon që aktivet financiare të klasifikohen në Fazën 2 kur shfaqin ndjeshmëri më të lartë ose rreziku i tyre i kredisë është rritur ndjeshëm që nga njohja e tyre fillestare. Për këto asete, duhet të njihet një provigjon për humbjeje bazuar në ECL-të e tyre të jetës. Pavarësisht faktit se ky është një koncept i ri në krahasim me SNK 39, nëse do të ishte zbatuar më 31 dhjetor 2017, do të rezultonte megjithatë një provigjon i ngjashëm me provigjonet aktuale, pasi shumica e aktiveve financiare (kredi) që bëjnë pjesë në këtë kategori, do të kishin një mbulim të konsiderueshëm nga vlera aktuale neto e flukseve të mjeteve monetare që lidhen me zbatimin e kolateraleve.

Banka shqyrton nëse ka pasur një rritje të konsiderueshme në rrezikun e kredisë të një aktivi duke krahasuar probabilitetin e mospagesës gjatë gjithë jetës së aktivit pas njohjes fillestare të tij kundrejt rrezikut të mospagimit në fund të çdo periudhe raportuese. Në secilin rast, ky vlerësim bazohet në një vlerësim të ardhshëm që merr parasysh një numër skenarësh ekonomikë, në mënyrë që të njohë probabilitetin e humbjeve më të larta që lidhen me më shumë pikëpamje negative ekonomike.

Faza 3

Aktivtë financiarë do të përfshihen në Fazën 3 kur ka prova objektive që kredia është zhvlerësuar. Kriteret e provave të tilla objektive janë të njëjta sikurse sipas metodologjisë aktuale të SNK 39. Prandaj, Banka pret që popullata të jetë përgjithësisht e njëjtë në të dyja standardet.

Kreditë në Fazën 3, ku Banka ka llogaritur zhvlerësimin e SNK 39 në baza individuale, do të vazhdojë të llogaritet në të njëjtën bazë, por vlerat e realizueshme të kolateralit mund të rregullohen për të konsideruar mundësinë që këto vlera të jenë më të ulta në skenarët më të pafavorshëm makroekonomikë. Pritet që kreditë në fazën e tretë të jenë të njëjta me ato që konsiderohen të zhvlerësuar në përputhje me SNK 39. Kalkulimi i provigjionit do të jetë i njëjtë si për kreditë e fazës 2 me probabilitetin e mospagimit të vendosur 100%.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIME ENDE TË PA MIRATUARA (VAZHDIM)

• SNRF 9 Instrumentet Financiare (vazhdim)

Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

Parashikimet e ardhshme

Banka do të inkorporojë informacionin mbi parashikimet e ardhshme si në vlerësimin e rritjes së ndjeshme të rrezikut të kredisë ashtu edhe matjen e ECL-ve. Banka e konsideron informacionin parashikimeve të ardhshme për faktorët makroekonomikë (si p.sh., papunësia, rritja e PBB-së, inflacioni) dhe parashikimet ekonomike. Për të vlerësuar një sërë rezultatesh të mundshme, banka formulon tre skenarë: një rast bazë, një rast më të keq dhe një rast më të mirë.

Skenari bazë paraqet rezultatin më të mundshëm që rrjedh nga procesi normal i planifikimit financiar dhe procesit të buxhetimit të bankës, ndërsa skenarët më të mirë dhe më të keq paraqesin rezultate më optimiste ose pesimiste. Për çdo skenar, Banka do të zbatojë një qasje të ponderuar me probabilitet për të përcaktuar provigjontin për zhvlerësim.

Banka do të përdorë informacionin e brendshëm që vjen nga ekspertë të ekonomisë së brendshme, të kombinuara me informacione të jashtme të publikuara nga agjencitë qeveritare dhe parashikuese ekonomike ose institucionet financiare ndërkombëtare si Fondacioni Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore etj. Organet e brendshme të qeverisjes të Bankës do të miratojnë supozimet para se të aplikohen për skenarë të ndryshëm.

Menaxhimi i kapitalit

Banka ka bërë një vlerësim paraprak se si modeli i ri ECL do të ndikojë në strukturën e vazhdueshme të kapitalit rregullator të Bankës. Bazuar në analizën e deritanishme dhe faktin se rregullat e kapitalit rregullator nuk priten të ndryshojnë ose të përfshijnë provigjonet për efektin e SNRF9, Banka nuk parashikon ndonjë ndikim në kapitalin rregullator.

• SNRF 15 Të Ardhurat nga Kontratat me Konsumatorët

Efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018.

Kërkesat kryesore

SNRF 15 zëvendëson të gjitha kërkesat ekzistuese për të ardhurat në SNRF dhe zbatohet për të gjitha të ardhurat që rrjedhin nga kontratat me klientët, me përjashtim të rasteve kur kontratat janë në kuadër të standardeve të tjera, siç janë SNK 17 Qiradhënie (ose SNRF 16 Qiratë, nëse është e aplikuar). Kërkesat e saj gjithashtu sigurojnë një model për njohjen dhe matjen e fitimeve dhe humbjeve në dispozicion të disa aktiveve jo-financiare, duke përfshirë aktivet afatgjata material dhe aktivet jo-materiale.

Standardi përshkruan parimet që një njësi ekonomike duhet të aplikojë për të matur dhe njohur të ardhurat. Parimi bazë është që një njësi ekonomike do të njohë të ardhurat në një shumë që reflekton shumën në të cilën njësi ekonomike pret të ketë të drejtë në këmbim të transferimit të mallrave ose shërbimeve për një klient.

Parimet në SNRF 15 duhet të zbatohen duke përdorur një model me pesë hapa:

1. Identifikoni kontratën me një klient
2. Identifikoni detyrimet e performancës në kontratë
3. Përcaktoni çmimin e transaksionit
4. Shpërndani çmimin e transaksionit ndaj detyrimeve të performancës në kontratë
5. Njohja e të ardhurave kur (ose si) njësi ekonomike përmbush një detyrim të performances

Sqarime në SNRF 15

Ndryshimet kanë një datë efektive, 1 janar 2018, që është data efektive e SNRF 15. Subjekteve u kërkohet të zbatojnë këto ndryshime në mënyrë retrospektive. Amendamentet synojnë të sqarojnë kërkesat në SNRF 15, jo për të ndryshuar standardin.

Subjektet mund të zgjedhin të zbatojnë standardin duke përdorur ose një qasje të plotë retrospektive ose një qasje të modifikuar retrospektive, me një lehtësim të kufizuar të ofruar sipas secilës ose metodë. Aplikimi i hershëm lejohet dhe duhet të publikohet.

SNRF 15 është më përshkruar sesa kërkesat aktuale të SNRF për njohjen e të ardhurave dhe ofron më shumë udhëzime për aplikim. Përshtatja do të jetë një ndërmarrje më e rëndësishme për shumicën e subjekteve me ndryshime të mundshme në kontabilitetin e tyre aktual, sistemet dhe proceset. Prandaj, një implementim i suksesshëm do të kërkojë një vlerësim dhe një plan për menaxhimin e ndryshimit.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIME ENDE TË PA MIRATUARA (VAZHDIM)

• SNRF 16 Qiratë

SNRF 16 është lëshuar në janar 2016 dhe zëvendëson SNK 17 Qiradhënie, KIRFN 4 Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një qira, SIC-15 Nxitjet e Qirasë Operative dhe KIS-27 Vlerësimi i Substancës së Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qirasë. SNRF 16 përcakton parimet për njohjen, matjen, paraqitjen dhe dhënien e informacioneve shpjeguese të qirasë dhe kërkon që qiramarrësit të japin llogari për të gjitha qiratë sipas një modeli të vetëm në bilanc, ngjashëm me kontabilitetin për qiratë financiare sipas SNK 17. Qiramarrësit do t'i kërkohej të njoh veçmas shpenzimet e interesit në detyrimet e qirasë dhe shpenzimet e amortizimit në aktivin e të drejtës së përdorimit.

Qiramarrësit gjithashtu do t'i kërkohej që të rilogarisë detyrimin e qirasë me rastin e ngjarjeve të caktuara (p.sh., një ndryshim në afatin e qirasë, një ndryshim në pagesat e qirasë të ardhshme që rezultojnë nga një ndryshim në një indeks apo normë të përdorur për të përcaktuar këto pagesa). Qiramarrësi në përgjithësi do të njohë shumën e rivlerësimit të detyrimit të qirasë si një rregullim në aktivin e të drejtës së përdorimit.

Kontabiliteti i qiradhënësit sipas SNRF 16 është në thelb i pandryshuar nga kontabilizimi i sotëm sipas SNK 17. Qiradhënësit do të vazhdojnë t'i klasifikohen të gjitha qiratë duke përdorur të njëjtin parim klasifikimi si në SNK 17 dhe të bëjnë dallimin mes dy llojeve të qirasë: qiratë operative dhe financiare.

SNRF 16 është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019. Aplikimi i hershëm lejohet, por jo para se një entitet të zbatojë SNRF 15. Një qiramarrës mund të zgjedhë të zbatojë standardin duke përdorur një qasje të plotë retrospektive ose një modifikim retrospektiv. Dispozitat e tranzicionit të standardit lejojnë lehtësime të caktuara.

• Interpretimi i KIRFN 22 Transaksionet në valutë të huaj dhe Konsiderata paraprake

Interpretimi sqaron se në përcaktimin e kursit të këmbimit të çastit për t'u përdorur në njohjen fillestare të aktivit, shpenzimeve ose të ardhurave (ose një pjesë të tij) në lidhje me çregjistrimin e një aktivi jo-monetar ose detyrimi jomonetar që lidhet me shumën paraprake, data e transaksionit është data në të cilën një entitet fillimisht njeh aktivin jo-monetar ose pasivin jomonetar që rrjedh nga shuma paraprake. Nëse ka pagesa të shumëfishta ose faturat paraprakisht, atëherë entiteti duhet të përcaktojë datën e transaksionit për secilën pagesë ose marrje të konsideratës paraprake. Subjektet mund të aplikojnë ndryshimet në bazë të plotë retrospektive. Ndryshe, një entitet mund të zbatojë Interpretimin në mënyrë prospektive për të gjitha aktivet, shpenzimet dhe të ardhurat në fushën e saj që njihen fillimisht në ose pas:

(i) Fillimi i periudhës raportuese në të cilën entiteti për herë të parë zbaton interpretimin, Ose

(ii) Fillimi i një periudhe raportuese paraprake të paraqitur si informacion krahasues në pasqyrat financiare të periudhës raportuese në të cilën entiteti zbaton interpretimin e parë.

Interpretimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018. Aplikimi i hershëm i interpretimit lejohet dhe duhet të shpalojë. Megjithatë, pasi që praktika e tanishme e Bankës është në përputhje me Interpretimin, Banka nuk pret ndonjë efekt në pasqyrat financiare të saj.

• Interpretimi i KIRFN 23 Pasiguria mbi Trajtimin e Tatimit mbi të Ardhurat

Interpretimi trajton kontabilitetin për tatimin mbi të ardhurat kur trajtimet tatimore përfshijnë pasigurinë që ndikon në zbatimin e SNK 12 dhe nuk zbatohet për tatimet ose taksat jashtë fushëveprimit të SNK 12 dhe as nuk përfshin në mënyrë specifike kërkesat që lidhen me interesin dhe penalitetet në lidhje me trajtimin e pasigurt të tatimit.

Interpretimi trajton në mënyrë specifike sa vijon:

- Nëse një entitet i konsideron trajtimet e pasigurta tatimore veç e veç
- Supozimet që një entitet bën në lidhje me ekzaminimin e trajtimeve tatimore nga autoritetet tatimore
- Si një entitet përcakton fitimin e tatueshëm (humbje tatimore), bazat tatimore, humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe normat tatimore
- Si një entitet i konsideron ndryshimet në fakte dhe rrethana

Një entitet duhet të përcaktojë nëse duhet të konsiderojë çdo trajtim tatimor të pasigurt veçmas ose së bashku me një ose më shumë trajtime të tjera tatimore të pasigurta. Qasja që parashikon më mirë zgjidhjen e pasigurisë duhet të ndiqet. Interpretimi është efektiv për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019, por janë të disponueshme disa lehtësime të tranzicionit. Banka do të zbatojë interpretimin nga data e hyrjes në fuqi. Megjithatë, Banka vepron në një mjedis tatimor në ndryshim, zbatimi i Interpretimit mund të ndikojë në pasqyrat e saj financiare dhe në zbulimet e kërkuara. Përveç kësaj, Banka mund të ketë nevojë të krijojë procese dhe procedura për të marrë informacionin që është i nevojshëm për të zbatuar Interpretimin në kohën e duhur.

• Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshime në SNRF 9

Ndryshimet kanë për qëllim të zbatohen kur shuma e parapagimit përafrohet me shumën e papaguara të principalit dhe interesit plus ose minus një shumë që pasqyron ndryshimin në një normë interesi referimi. Kjo nënkupton që parapagimet me vlerën e drejtë aktuale ose në një shumë që përfshin vlerën e drejtë të koston për të përfunduar një instrument mbrojtës të lidhur normalisht do të përmbushin kriterin e SPPI vetëm nëse elementët e tjerë të ndryshimit në vlerën e drejtë, të tilla si efektet e kredisë rreziku ose likuiditeti, janë të vogla.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

4. STANDARDET E REJA DHE INTERPRETIME ENDE TË PA MIRATUARA (VAZHDIM)

• Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ - Ndryshime në SNRF 9 (vazhdim)

Më shumë gjasa, shpenzimet për të ndërprerë një shkëmbim të normave të interesit "vanilje të thjeshtë" të kolateralizuara, në mënyrë që të minimizohen rreziqet e kredisë për palët në shkëmbim, do të përmbushin këtë kërkesë. Ndryshimet duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive; lejohet të aplikohet më herët. Amendimi siguron dispozita specifike të tranzicionit nëse zbatohet vetëm në vitin 2019 dhe jo në 2018 me pjesën tjetër të SNRF 9. Amendimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

Standarde të tjera të ndryshuara të nxjerra por jo të miratuara ende që nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm të pasqyrave financiare të Bankës janë si më poshtë:

• **Aplikimi i SNRF 9 Instrumentat Financiarë me SNRF 4 Kontratat e Sigurimeve** - Ndryshime në SNRF 4, përjashtimi i përkohshëm aplikohet për herë të parë për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018.

• **Transferrat e Pronave të Investimit** - Ndryshimet në SNK 40, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018.

• **Ndryshimet në SNRF 10 dhe SNK 28: Shitja ose Kontributi i Aktiveve midis një Investitori dhe Shoqatës së saj ose Sipërmarrjes së Përbashkët**, IASB ka shtyrë datën efektive të këtyre ndryshimeve për një kohë të pacaktuar

• **Interesat afatgjata në Shoqatë dhe Sipërmarrje të përbashkëta** - Ndryshime në SNK 28, efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

Përmirësimet vjetore për ciklin 2014-2016 (lëshuar në dhjetor 2016)

Këto përmirësime përfshijnë:

- **SNRF 1 Përshtatja e parë e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar** - Zhdukja e përjashtimeve afatshkurtra për përshtatesit e pare, hyn në fuqi që nga 1 janari 2018.
- **SNK 28 Investimet në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta** - Sqarimi që matja e të investuarve me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes është një zgjedhje për investim pas investimi, hyn në fuqi nga 1 janari 2018, por lejohet aplikimi i hershëm.
- **SNRF 17 Kontratat e Sigurimeve** efektive për periudhat e raportimit që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021, me shifra krahasuese të nevojshme.
- **SNRF 2 Klasifikimi dhe matja e transaksioneve të pagesave të bazuara në aksione** - Ndryshime në SNRF 2 efektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2018, me lejin e aplikimit të hershëm.

Përmirësimet vjetore për ciklin 2015-2017 (lëshuar në dhjetor 2017)

Këto përmirësime përfshijnë:

- **SNRF 3 Kombinimet e Biznesit** - Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët, për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.
- **SNRF 11 Marrëveshjet e Përbashkëta** - Interesat e mbajtura më parë në një operacion të përbashkët, për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.
- **SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat** - Pasojat e tatimit mbi të ardhurat e pagesave të instrumenteve financiare të klasifikuara si capital, për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.
- **SNK 23 Kostot e Huamarrjes** - Kostot e huamarrjes të pranueshme për kapitalizim, për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

5. STANDARDET E LËSHURA, DHE EFEKTIVE PËR PERIUDHËN VJETORE

• SNK 7 Iniciativa për dhënie informacionesh shpjeguese - Ndryshime në SNK 7

Amendimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. Ndryshimet në SNK 7 Pasqyra e flukseve të mjeteve monetare është pjesë e Iniciativës së Publikimit të BSNK-së dhe ndihmojnë përdoruesit e pasqyrave financiare të kuptojnë më mirë ndryshimet në borxhin e një entiteti. Ndryshimet kërkojnë që entitet të japin informacion shpjegues rreth publikimeve në detyrimet e tyre që rrjedhin nga aktivitetet e financimit, duke përfshirë edhe ndryshimet që rrjedhin nga flukset e mjeteve monetare dhe ndryshimet jo-kesh (siç janë fitimet ose humbjet në valutë të huaj). Në aplikimin fillestar të amendamenteve, entiteteve nuk u kërkohej të japin informacion krahasues për periudhat e mëparshme. Banka ka zbatuar amendamentin dhe ka paraqitur informacion shpjegues shtesë për ndryshimet në detyrimet që rrjedhin nga aktivitetet e financimit në shënimin 22.

• SNK 12 Njohja e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuar - Ndryshimet në SNK 12

Ndryshimi është efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2017. IASB ka lëshuar amendimet në SNK 12 Tatimet mbi të Ardhurat për të sqaruar kontabilizimin për aktivet tatimore të shtyra për humbjet e parealizuar mbi instrumentet e borxhit të matura me vlerën e drejtë. Amendamentet sqarojnë se një entitet duhet të marrë në konsideratë nëse ligji tatimor kufizon burimet e fitimeve të tatueshme, ndaj të cilave mund të bëjë zbritje për kthimin e kësaj difference të përkohshme të zbritshme. Për më tepër, ndryshimet sigurojnë udhëzime se si një entitet, duhet të përcaktojë fitimet e tatueshme në të ardhmen dhe të shpjegojë rrethanat në të cilat fitimi i tatueshëm mund të përfshijë rikuperimin e disa pasurive për më shumë sesa vlera e tyre kontabël. Entitetet u kërkohej të aplikojnë ndryshimet në mënyrë retrospektive. Megjithatë, në aplikimin fillestar të ndryshimeve, ndryshimi në kapitalin fillestar të periudhës krahasuese më të hershme mund të njihet në fitimet e pashpërndara të hapura (ose në një pjesë tjetër të kapitalit neto, sipas rastit), pa akorduar ndryshimin midis fitimit të pashpërndarë të hapur dhe komponentëve të tjerë të kapitalit. Entitetet që aplikojnë ndryshimet më herët duhet ta publikojnë këtë fakt. Ndryshimet synojnë të heqin divergjencën ekzistuese në praktikë në njohjen e aktiveve tatimore të shtyra për humbjet e parealizuar. Ky ndryshim nuk është i zbatueshëm për Bankën.

• Deklarata e praktikave të SNRF-ve 2: Marrja e vendimeve të materialitetit

Shoqërive u lejohej të zbatojnë udhëzimet në Deklaratën e Praktikës (DP) në pasqyrat financiare të përgatitura në çdo periudhë kohore pas 14 shtatorit 2017. DP përmban udhëzime jo të detyrueshme për të ndihmuar entitetet që të bëjnë gjykime materialiteti gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme. Gjithashtu, DP, mund të ndihmojë përdoruesit e pasqyrave financiare për të kuptuar se si një entitet bën gjykime të materialitetit në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Deklarata e Praktikës përmban udhëzime në tri fusha kryesore:

• Karakteristikat e përgjithshme të materialitetit

• Një proces me katër hapa që mund të zbatohet në bërjen e gjykimeve të materialitetit gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare. Ky proces përshkruan se si një entitet mund të vlerësojë nëse informacioni është material për qëllimet e njohjes, matjes, prezantimit dhe zbulimit.

• Si të bëhen gjykimet e materialitetit në rrethana specifike, domethënë, informacionet e mëparshme, gabimet dhe besëlidhjet dhe në kontekstin e raportimit të përkohshëm.

Për më tepër, DP diskuton ndërveprimin ndërmjet vendimeve të materialitetit që një entitet duhet të bëjë dhe ligjet dhe rregulloret vendore. DP përfshin shembuj që ilustrojnë se si një njësi ekonomike mund të zbatojë udhëzimet. Meqenëse DP është një dokument jo i detyrueshëm, ai nuk ndryshon ose nuk paraqet ndonjë kërkesë në SNRF. Sidoqoftë, DP siguron udhëzime të dobishme për subjektet që bëjnë gjykime të materialitetit dhe në këtë mënyrë mund të përmirësojnë efektivitetin e komunikimit të pasqyrave financiare.

Banka ende nuk ka bërë asnjë gjykim të materialitetit.

Përmirësimet vjetore për ciklin 2014-2016 (lëshuar në dhjetor 2016)

Këto përmirësime përfshijnë:

- **SNRF 12 Publikimi i interesave në entitete të tjera**, hyn në fuqi nga 1 janari 2017 dhe duhet të zbatohen në mënyrë retrospektive.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozon Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kredisë
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- menaxhimi i kapitalit

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat e Bankës, politikat dhe proceset e Bankës për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut, dhe menaxhimin e kapitalit të Bankës.

Kuadri i administrimit të rrezikut

Bordi i Drejtorëve ka përgjegjësi për vendosjen dhe për mbikëqyrjen e kuadrit të menaxhimit të rrezikut të Bankës. Bordi ka krijuar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO), Komitetin e Rrezikut të Kredisë dhe Çështjeve Sensitive (SAC) dhe komitetin e Provizionimit të cilët kanë përgjegjësi për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të menaxhimit të rrezikut të Bankës në fushat e tyre specifike. Të gjithë komitetet e Bordit kanë anëtarë ekzekutivë dhe jo ekzekutivë dhe raportojnë rregullisht tek Bordi i Drejtorëve për aktivitetet e tyre.

Politikat e menaxhimit të rrezikut të Bankës janë hartuar që të evidentojnë dhe të analizojnë rreziqet që hasen nga Banka, që të vendosin limite dhe kontrole të përshtatshme për rreziqet, dhe që të monitorojnë rreziqet dhe zbatimin e kufijve. Politikat dhe sistemet e menaxhimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të pasqyruar ndryshimet në kushtet e tregut, produktet dhe shërbimet e ofruara.

Banka, përmes standardeve dhe procedurave të trajnimit dhe të menaxhimit synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe të strukturuar, ku të gjithë punonjësit të kuptojnë rolet dhe detyrimet e tyre. Komiteti i Kontrollit të Bankës ka përgjegjësi për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e menaxhimit të rrezikut të Bankës dhe për rishikimin e mjaftueshmërisë së kuadrit të menaxhimit të rreziqeve të hasura nga Banka. Komiteti i Kontrollit të Bankës asistohet në këto funksione nga Kontrolli i Brendshëm. Kontrolli i Brendshëm kryen rishikime të rregullta dhe të posaçme të kontrollit dhe procedurave të menaxhimit të rrezikut, rezultatet e të cilave i raportohen Komitetit të Auditit.

(a) Rreziku i kredisë

Gjatë aktivitetit normal të saj, Banka ekspozohet ndaj rrezikut të kredisë nga huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve dhe institucioneve financiare, nga investimet në letra me vlerë dhe në zëra të tjerë jashtë bilancit. Rreziku i kredisë është rreziku i humbjes financiare të Bankës në rast se huamarrësi ose pala tjetër e një instrumenti financiar nuk përmbush detyrimet e tij kontraktuale, dhe ky rrezik buron kryesisht nga huatë dhe paradhëniet e klientëve dhe nga letrat me vlerë të borxhit dhe financimet ndaj institucioneve financiare ose zëra të tjera jashtë bilanci. Për qëllime të raportimit të menaxhimit të rrezikut, Banka konsideron dhe konsolidon të gjitha elementet e ekspozimit të rrezikut të kredisë (si rreziku i mospërmbushjes së detyrimit individual, rreziku sovran ose i industrisë). Banka menaxhon rrezikun e ekspozimit të kredisë sistematikisht duke monitoruar drejtëpërdrejtë limitet e kredive, portofolin e kredive dhe përqëndrimin e ekspozimit.

Menaxhimi i rrezikut të kredisë

Bordi i Drejtorëve ka deleguar përgjegjësitë për administrimin e rrezikut të kredisë tek Komiteti i Kredisë së Bankës. Për mbikëqyrjen e rrezikut të kredisë së Bankës është përgjegjëse Njësia e Rrezikut të Kredisë, e cila raporton tek Drejtori Ekzekutiv. Menaxhimi i rrezikut të kredisë realizohet përmes:

Krijimit të politikave të rrezikut të kredisë në konsultim me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, vlerësimin e kredive, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut, procedurave të shkruara ligjore, dhe pajtueshmëria me kriteret rregullatore dhe ligjore.

Vendosjes dhe monitorimit të niveleve të delegimit dhe procesit të shkallëzimit në lidhje me miratimet e kredisë. Bordi i Drejtorëve i ka deleguar Komitetit të Kredisë autoritetin për miratimin e shumave deri në ekuivalentin e 3,000,000 EURO për rritjen e limiteve ekzistuese të kredive apo dhënien e kredive të reja, dhe deri në ekuivalentin e 5,000,000 EURO për rinovimin ose ristrukturimin e kredive aktuale. Megjithatë për financimin e sektorëve të veçantë të ekonomisë dhe palëve të tjera të cilat konsiderohen me rrezik të tilla si sektori i pasurive të paluajtshme, ndërtimi, hoteleria, investimet fillestare, institucionet financiare, personat politikë etj., autoriteti për miratimin e kredive i mbetet Bordit të Drejtorëve pavarësisht shumës së financimit.

Rishikimit dhe vlerësimit të rrezikut të kredisë. Menaxhimi i Bankës dhe Sektori i Vlerësimit të Rrezikut të Kredisë vlerëson të gjithë kufijtë e ekspozimit të kredisë, përpara miratimit përfundimtar nga autoriteti kompetent. Rinovimet dhe rishikimet e huave janë subjekt i po të njëjtit proces.

Kufizimit të përqëndrimit të ekspozimit ndaj kundërpasive, qofshin përqëndrime gjeografike apo sektoriale të ekonomisë (për kreditë dhe paradhëniet) dhe sipas emetuesit, klasifikimit të kredive, likuiditetit të tregut dhe shtetit (për investimet në letra me vlerë).

Zhvillimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të vlerësimit të rrezikut të Bankës për të kategorizuar ekspozimin sipas shkallës së rrezikut të humbjes financiare me të cilën përballohet Banka dhe për të fokusuar drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Klasifikimi i rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur mund të kërkohej zhvlerësim kundrejt ekspozimeve specifike të kredisë.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Menaxhimi i rrezikut të kredisë (vazhdim)

Kuadri aktual i klasifikimit të rrezikut konsiston në pesë kategori: a) standarde, b) në ndjekje, c) nën-standarde, d) e dyshimtë dhe e) e humbur. Kreditë e klasifikuara në dy kategoritë e para konsiderohen si kredi pa probleme. Kreditë e tre kategorive të tjera konsiderohen si kredi me probleme. Përveç kriterit të ditëvonesave, Banka gjithashtu përdor kriteret cilësore të mëposhtme për përcaktimin e kategorizimit të rrezikut të kredive:

- Aftësia paguese
- Kushtet financiare
- Aftësitë menaxhuese
- Kolateralin dhe garantët
- Struktura e kredive

Kreditë me kushte të rinegociueshme janë kredi që janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të huamarrësit dhe për të cilat Banka ka bërë lëshime që përndryshe nuk do ti konsideronte. Kreditë me kushte të rinegociueshme janë konsideruar si të zhvlerësuar individualisht në vitin e parë që nga implementimi i ristrukturimit.

Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë

	Ekspozimi Maksimal Bruto	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mjete monetare dhe të ngjashme (me përjashtim të mjeteve monetare në arkë)	5,781,933	3,201,775
Hua dhe paradhënie bankave	2,718,602	3,100,740
Letra me vlerë të vendosjes	10,803,880	10,970,639
Letra me vlerë të investimit	7,879,715	6,888,858
Hua dhe paradhënie klientëve	9,285,162	9,263,182
Qera Financiare	78,499	-
Debitorë të tjerë	12,327	28,643
Totali i ekspozimit për zërat e bilancit	36,560,118	33,453,837
Angazhime të patërheqshme ndaj klientëve	323,475	429,535
Garanci në favor të klientëve	512,288	1,497,848
Totali i angazhimeve të lidhura me kredinë	835,763	1,927,383
Totali i rrezikut të kredisë	37,395,882	35,381,220

Nëse aktivet financiare regjistrohen me vlerën e drejtë, shumat e paraqitura përfaqësojnë ekspozimin aktual të rrezikut të kredisë, por jo ekspozimin maksimal që mund të lindë në të ardhmen si rezultat i ndryshimeve në vlera. Banka vë në dispozicion të klientëve të saj garanci të cilat mund kërkojnë që Banka të bëjë pagesa në favor të tyre dhe të marrë angazhime për të zgjeruar linjat e kredisë për t'ju siguruar likuiditetin e nevojshëm. Angazhime të tilla e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të ngjashme të kredisë, të cilat zbuten me të njëjtat politika dhe procese kontrolli. Çdo muaj Banka vlerëson angazhimet e lidhura me kredinë për zhvlerësim. Shumat subjekt i vlerësimeve individuale për zhvlerësim janë angazhime të pa-anullueshme dhënë klientëve të këqinj ose klientëve me kredi të ristrukturuara.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Tabelat e mëposhtme paraqesin cilësinë e kredisë së aktiveve financiare të ekspozuara ndaj rrezikut të kredisë, bazuar në klasifikimin e brendshëm të bankës. Portofoli i kredive pa probleme konsiderohet si jo në vonesë dhe jo i zhvlerësuar individualisht. Aktivitetet financiare në tabelat më poshtë janë të paraqitura bruto pa zbritur zhvlerësimet për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016.

31 dhjetor 2017	Jo në vonesë dhe jo të zhvlerësuara individualisht	Në vonesë, por jo të zhvlerësuara individualisht	Të zhvlerësuara individualisht	Totali
Mjete monetare dhe të ngjashme (pa përfshirë paranë në arkë)	5,781,934	-	-	5,781,934
Hua dhe paradhënie bankave	2,718,602	-	-	2,718,602
Hua dhe paradhënie klientëve:	9,834,632	157,784	861,027	10,853,443
Hua tregtare	6,833,723	19,476	663,050	7,516,249
Hua hipotekore	2,743,482	111,458	187,937	3,042,877
Hua konsumatore	257,427	26,850	10,040	294,317
Qera Financiare	81,346	-	-	81,346
	18,416,514	157,784	861,027	19,435,325
Investimet në letra me vlerë:				
Qeveria Shqiptare	18,683,595	-	-	18,683,595
	18,683,595	-	-	18,683,595
Totali	37,100,109	157,784	861,027	38,118,920

31 dhjetor 2016	Jo në vonesë dhe jo të zhvlerësuara individualisht	Në vonesë, por jo të zhvlerësuara individualisht	Të zhvlerësuara individualisht	Totali
Mjete monetare dhe të ngjashme (pa përfshirë paranë në arkë)	3,201,775	-	-	3,201,775
Hua dhe paradhënie bankave	3,100,740	-	-	3,100,740
Hua dhe paradhënie klientëve:	8,841,824	250,657	1,255,878	10,348,359
Hua tregtare	5,929,115	92,578	975,740	6,997,433
Hua hipotekore	2,641,041	155,417	270,170	3,066,628
Hua konsumatore	271,668	2,662	9,968	284,298
	15,144,339	250,657	1,255,878	16,650,874
Investimet në letra me vlerë:				
Qeveria Shqiptare	17,859,497	-	-	17,859,497
	17,859,497	-	-	17,859,497
Totali	33,003,836	250,657	1,255,878	34,510,371

Sikurse më 31 dhjetor 2017, kreditë e zhvlerësuara individualisht kanë rënë kryesisht për shkak të shlyerjeve dhe fshirjeve të kredive të bëra gjatë viteve.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e Kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Një analizë vjetërsie e kredive jo në vonesë dhe jo të zhvlerësuar individualisht më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

31 dhjetor 2017	Më pak se 30 ditë	31 në 60 ditë	61 në 90 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	6,493,366	268,831	71,526	6,833,723
Hua hipotekore	2,470,260	119,065	154,157	2,743,482
Hua konsumatore	250,633	5,083	1,711	257,427
Qera Financiare	81,346	-	-	81,346
Totali	9,295,605	392,979	227,394	9,915,978

31 dhjetor 2016	Më pak se 30 ditë	31 në 60 ditë	61 në 90 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:				
Hua tregtare	5,725,812	190,907	12,396	5,929,115
Hua hipotekore	2,443,518	146,072	51,451	2,641,041
Hua konsumatore	269,789	1,223	656	271,668
Totali	8,439,119	338,202	64,503	8,841,824

Një analizë vjetërsie e kredive në vonesë por jo të zhvlerësuar më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

31 dhjetor 2017	91 në 180 ditë	më shumë se 180 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:			
Hua tregtare	1,876	17,600	19,476
Hua hipotekore	58,502	52,956	111,458
Hua konsumatore	2,211	24,639	26,850
Totali	62,589	95,195	157,784

31 dhjetor 2016	91 në 180 ditë	më shumë se 180 ditë	Totali
Hua dhe paradhënie klientëve:			
Hua tregtare	85,288	7,290	92,578
Hua hipotekore	101,029	54,388	155,417
Hua konsumatore	867	1,795	2,662
Totali	187,184	63,473	250,657

Huatë dhe letrat me vlerë të zhvlerësuar

Huatë e zhvlerësuar janë ato për të cilat Banka vlerëson se mund të mos jetë në gjendje të mbledhë principalin dhe interesin e arkëtueshëm sipas kushteve kontraktuale të marrëveshjes(ve). Banka i klasifikon huadheniet dhe paradhëniet ndaj klientëve në kategori pa probleme dhe me probleme siç përshkruhet më lart dhe kryen teste të zhvlerësimit për të gjitha huatë që shfaqin evidenca objektive për zhvlerësim, duke vlerësuar fluksin e skontuar monetar të ardhshëm dhe duke e krahasuar me vlerën kontabël të mbetur respektive të huasë. Huatë, të cilat nuk paraqesin evidenca për t'u zhvlerësuar individualisht, vlerësohen për zhvlerësim në grup. Zhvlerësimi në grup aplikohet gjithashtu edhe për klientë të testuar individualisht por që kanë rezultuar të mos kenë nevojë për zhvlerësim individual.

Fondi për humbjet nga zhvlerësimi

Banka krijon një fond për humbjet nga zhvlerësimi i kredive që përfaqëson një përlogaritje për humbjet e realizuara në portofolin e kredive. Komponentët kryesorë të këtij fondi përfshijnë komponentin e humbjes specifike që lidhet me ekspozime individualisht të rëndësishme si dhe me ekspozime më pak të rëndësishme dhe të vlerësuar në grup dhe me një fond humbjes nga kreditë në grup i krijuar për grupe homogjene aktivesh, në lidhje me humbjet që janë pësuar, por akoma nuk janë të identifikuar në kreditë që janë subjekt i vlerësimeve për zhvlerësim individual.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Cilësia e Kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare (vazhdim)

Kreditë me kushte të rinegociueshme

Kushtet kontraktuale të një kredie mund të modifikohen për një sërë arsesh, duke përfshirë ndryshimet në kushtet e tregut, ruajtjen e mardhënies me klientin dhe faktorë të tjerë jo të lidhura me një përkeqësim aktual ose potencial të situatës së kreditorit. Një kredi ekzistuese termat e së cilës janë modifikuar mund të çregjistrohet dhe kredia e rinegociuar mund të njihet si një kredi e re me vlerë të drejtë. Banka rinegocion kreditë e klientëve në vështirësi financiare (të referuara si "aktivitete në ristrukturim") për të maksimizuar mundësitë e grumbullimit dhe të minimizojnë rrezikun e mospagimit.

Pavarësisht nëse kreditë me kushte të rinegociueshme janë çregjistruar, ato vazhdojnë të paraqiten si të zhvlerësuar deri sa provohet se rreziku i mospagimit së flukseve monetare të ardhshme është reduktuar ndjeshëm dhe nuk ka tregues të tjerë për zhvlerësim.

Cilësia e Kredisë sipas kategorive të aktiveve financiare

Tabela më poshtë tregon huatë dhe paradhëniet neto ndaj klientëve të klasifikuara në dy grupe kryesore: Të zhvlerësuar individualisht dhe në grup. Lëvizjet për zhvlerësimet e qirasë financiare janë paraqitur në shënimin 14.

	Ekspozimi Neto i huave dhe paradhëniet ndaj klientëve	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të zhvlerësuar individualisht		
Balanca bruto	861,027	1,255,878
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(780,209)	(792,266)
Vlera kontabël	80,818	463,612
Të zhvlerësuar në grup		
Balanca bruto	9,992,416	9,092,481
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(788,072)	(292,911)
Vlera kontabël	9,204,344	8,799,570
Total i vlerës kontabël të Huave dhe paradhëniet për klientët	9,285,162	9,263,182

Lëvizjet e veçanta për zhvlerësimet individuale dhe në grup paraqiten të detajuara në shënimin 13.

Tabela më poshtë tregon qerat financiare të kategorizuar brenda dy grupeve kryesore: të zhvlerësuar individualisht dhe në grup.

	Ekspozimi neto per Qira Financiare	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Të zhvlerësuar individualisht		
Balanca bruto	-	-
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	-	-
Vlera kontabël	-	-
Të zhvlerësuar në grup		
Balanca bruto	81,346	-
Zbritja për humbjet nga zhvlerësimi	(2,847)	-
Vlera kontabël	78,499	-
Total i vlerës kontabël të Huave dhe paradhëniet për klientët	78,499	-

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Më poshtë paraqitet një analizë e balancave bruto dhe neto (nga zbritja për humbjet nga zhvlerësimi) për huatë e zhvlerësuar individualisht sipas klasifikimit të rrezikut:

	Hua dhe paradhënie klientëve të zhvlerësuar individualisht	
	Bruto	Neto
31 dhjetor 2017		
Hua të dyshimta	403,624	80,818
Hua të humbura	457,403	-
Totali	861,027	80,818
31 dhjetor 2016		
Hua të dyshimta	683,029	191,150
Hua të humbura	572,849	272,462
Totali	1,255,878	463,612

Më poshtë paraqitet vlera kontabël e huave dhe paradhënieve të ristrukturuara të klientëve, neto nga zbritja për humbjet nga zhvlerësimi, sipas produkteve:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Hua tregtare	518,257	1,136,928
Hua hipotekore	292,302	216,033
Hua konsumatore	-	74
Totali	810,559	1,353,035

Politikat e fshirjes nga librat kontabël

Banka fshin nga librat e saj një gjëndje huaje/letre me vlerë (dhe zbritjet për zhvlerësime nga humbje të lidhura me të) kur Komiteti i Çështjeve Sensitive dhe Provigjonimit (SAC) përcakton se huaja/letra me vlerë është e pa arkëtueshme. Ky vendim arrihet pas marrjes në konsideratë të informacioneve për ndryshime të rëndësishme në pozicionin financiar të huamarrësit/emetuesit, të tilla që huamarrësi/emetuesi nuk mund të paguajë më detyrimet, dhe përfitimet nga kolaterale nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë ekspozimin. Për kreditë e standartizuara me vlerë më të vogël, vendimet për fshirjen, bazohen në statusin specifik të vonësive në pagesa të produktit si edhe në veprimet ligjore të ndjekura lidhur me proçedurën e zbatimit.

Banka zotëron kolateral kundrejt kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve. Banka zbaton udhëzimet e saj të brendshme mbi pranueshmërinë e klasave specifike të kolateraleve ose të teknikave të zbutjes së rrezikut të kredisë. Banka zotëron kolaterale kryesisht në formën e:

- Hipotekave të pasurive të paluajtshme rezidenciale ose të biznesit;
- Pengjeve mbi aktivet e biznesit në funksionim, të tilla si makineri dhe pajisje, inventare dhe llogari të arkëtueshme;
- Mjete monetare të lëna garanci dhe letra me vlerë (si Bono Thesari), etj.

Vlerësimet e vlerës së drejtë bazohen në vlerën e kolateralit të vlerësuar në kohën e huamarrjes dhe përgjithësisht përditësohen mbi baza vjetore.

Flukset e parashikuara të të ardhurave nga kolaterale përfshirë garancitë që mbulojnë ekspozimet janë zakonisht burimi kryesor i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare nga kreditë me probleme. Disa nga parametrat e vlerësimit të përdorura për llogaritje janë:

• **Vlera e realizueshme e kolateraleve**, e cila përllogaritet duke ulur vlerën e tregut të kolateraleve me një 'faktor skontimi'. Kjo merr në konsideratë karakteristikat e grupeve të ngjashme të kolateraleve dhe supozon një vlerë mesatare të rikuperueshme të një kolaterali të caktuar, bazuar në eksperiencën e Bankës.

• **Koha e flukseve të parashikuara/pritura të parasë**, e cila i referohet kohës së pritshme të rikuperimit (në vite) të një lloji të caktuar kolaterali.

Për hua dhe paradhënie ndaj institucioneve financiare përgjithësisht nuk mbahet kolateral, përveç kur instrumentet financiare mbahen si pjesë e marrëveshjeve të riblerjeve dhe aktivitetit të huamarrjes të letrave me vlerë.

Për qëllimin e llogaritjes së zhvlerësimit individual të kredive dhe paradhënieve ndaj klientëve, kolaterale që janë marrë në konsideratë për llogaritjen e zhvlerësimit janë vetëm pasuritë e paluajtshme, mjetet monetare të vendosura si kolateral dhe garancitë bankare.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Politikat e fshirjes nga librat kontabël (vazhdim)

Nuk ka kolaterale mbi huatë dhe paradhëniet ndaj bankave përveç rasteve të marrëveshjeve të riblerjes të anasjelltja. Për pjesën me të madhe të portofolit të kredisë vlera e drejtë e kolateralit tejkalon shumën e kredive, megjithatë, Banka normalisht e skanton vlerën e drejtë të kolateralit me të paktën 44% (2015: 40%) në mënyrë që të mbajë parasysh vështirësitë praktike dhe administrative të ekzekutimit të një kolaterali. Në këtë mënyrë Banka mbrohet nga mospagesat e mundshme nga klienti.

Një përlogaritje e vlerës së drejtë të paskontuar dhe të skontuar të kolateraleve dhe garancive të tjera, të mbajtura kundrejt aktiveve financiare tregohet më poshtë:

	Kolaterale për Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve		Kolaterale për Huatë dhe paradhëniet ndaj klientëve	
	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Paskontuar	Skontuar	Paskontuar	Skontuar
Ndaj të zhvlerësuarave				
Ndërtesa	267,402	128,406	2,019,536	1,107,095
Pengje dhe garanci	-	-	-	-
Totali	267,402	128,406	2,019,536	1,107,095
Vlera kontabël neto		80,818		463,612
Ndaj të zhvlerësuarave në grup				
Ndërtesa	27,945,741	13,828,137	25,198,069	13,737,273
Mjete monetare	441,138	441,138	880,228	880,228
Totali	28,386,879	14,269,275	26,078,297	14,617,501
Vlera kontabël neto:		9,204,344		8,825,836

Ekspozimi maksimal bruto nëse kolaterale nuk do të merren në konsideratë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 janë:

Të zhvlerësuar individualisht	Viti 2017			Viti 2016		
	Shuma Bruto	Dëmtim	Balanca Neto	Shuma Bruto	Dëmtim	Balanca Neto
Tipi kolateralit						
Ndërtesa	175,269	175,269	-	1,271,194	1,271,194	-
Mjete monetare	-	-	-	1,421	1,421	-
Totali	175,269	175,269	-	1,272,615	1,272,615	-
Të zhvlerësuar në grup						
Tipi kolateralit						
Ndërtesa	8,539,726	899,133	7,640,593	7,790,234	1,059,669	6,730,565
Mjete monetare	207,651	7,284	200,367	139,880	1,491	138,389
Totali	8,747,377	906,417	7,840,960	7,930,114	1,061,160	6,868,954

Në rastin e kolateraleve të marra në pronësi, qëllimi kryesor i Bankës është konvertimi i tyre në mjete monetare, nëpërmjet fushatave promovionale për shitjen e tyre. Të ardhurat e mbledhura përdoren për zvogëlimin ose likuidimin e vlerës së mbetur të kredive. Nëse nuk ka asnjë ofertë të kënaqshme, praktika e Bankës është të mbajë aktivin në inventarët e saj për shitje deri sa të marrë ofertën më të mirë. Në varësi të nevojave operacionale të Bankës dhe përshtatshmërisë së aktivitetit për t'i plotësuar ato nevoja, menaxhimi vendos ta verë në përdorim pasurinë, në të tilla raste kryhet një riklasifikim në aktivet materiale në kategorinë afatgjatë. Natyra dhe vlerat përkatëse të aktiveve të marra në zotërim janë paraqitur në shënimin 17.

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumatat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Përqëndrimi i Rrezikut të Kredisë

Banka monitoron përqëndrimet e rrezikut të kredisë sipas sektorëve dhe vendit. Analiza e rrezikut të kredisë në datën e raportimit paraqitet si më poshtë:

Përqëndrimi sipas sektorëve	Hua dhe paradhënie ndaj klientëve, neto	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Shërbimet	666,647	1,169,055
Shitja me shumicë	1,675,106	2,790,618
Ndërtimi	370,900	269,490
Prodhimi	891,522	989,237
Pasuritë e patundshme	903,783	472,522
Të tjera	1,750,893	542,695
Biznese	6,258,851	6,233,617
Kredi hipotekore	2,774,512	2,823,729
Kredi konsumatore	251,799	205,836
Individë	3,026,311	3,029,565
Vlera kontabël	9,285,162	9,263,182

Përqëndrimi sipas sektorëve	Hua dhe paradhënie bankave	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Banka	5,078,902	3,126,071
Vlera kontabël	5,078,902	3,126,071

Përqëndrimi sipas sektorëve	Letra me vlerë	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Letra me vlerë të Qeverisë Shqiptare	18,683,595	17,859,497
Vlera kontabël	18,683,595	17,859,497

Cilësia e kredisë të ekspozimit maksimal të kredisë së letrave me vlerë të borxhit bazuar në klasifikimin Moody, kur është e zbatueshme, vijon si më poshtë:

Qeveria Shqiptare	Investime Financiare	
	Letrat me vlerë të borxhit	
	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Klasifikimi B1	18,683,595	17,859,497
	18,683,595	17,859,497

Portofoli i rrezikut të kredisë të Bankës karakterizohet nga përqëndrimet e mëposhtme të rrezikut të kredisë.

Pala tjetër për ekspozimin më të madh me bankat më 31 dhjetor 2017 është me një Bankë vendase, Banka Intesa San Paolo (2016: Bankë të huaj, Banka Credit Agricole). Pala tjetër për ekspozimin më të madh me klientët në 31 dhjetor 2017 është Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (2016: Korporata Elektroenergjitike Shqiptare).

	31 dhjetor 2017	Ekspozimi Në %	31 dhjetor 2016	Ekspozimi Në %
Letrat me vlerë të Republikës së Shqipërisë	18,683,595	51%	17,859,497	53%
Gjendjet me Bankën e Shqipërisë	6,022,488	16%	5,721,156	17%
Rreziku total me Qeverinë Shqiptare	24,706,083	68%	23,580,653	70%
Ekspozimi më i madh me Bankat	689,764	2%	556,028	2%
Ekspozimi më i madh me klientët	421,098	1%	467,216	1%
Totali i ekspozimeve të mëdha me bankat dhe klientët	1,110,862	3%	1,023,244	3%
Totali i rrezikut për zërat e bilancit	25,816,945	71%	24,603,897	73%

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE SHA

Shënime të pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

(Të gjithë shumat në mijë Lekë, përveç kur shprehet ndryshe)

6. MENAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(a) Rreziku i kredisë (vazhdim)

Rreziku i shlyerjes

Aktivitetet e Bankës mund të shkaktojnë rrezik në momentin e shlyerjes së transaksioneve dhe tregtimeve. Rreziku i shlyerjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një shoqërie në përmbushjen e detyrimeve të saj për të dhënë mjete monetare, letra me vlerë ose aktive të tjera ashtu siç është rënë dakort në kontratë. Rreziku i shlyerjes me institucione financiare dhe kundërpartinë tjetër qeveritare përfshihet brenda një sistemi limitesh për të gjitha transaksionet me këto kundërparti dhe është objekt i monitorimit të përditshëm, përcaktuar dhe rregulluar sipas rregullores së Bankës Qendrore të Shqipërisë "Për administrimin e rrezikut nga ekspozimet e mëdha të bankës"

(b) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është përcaktuar si paaftësia e mundshme e një institucioni për të përmbushur detyrimet që ka për shkak të pamjaftueshmërisë së likuiditetit ose pamundësisë për të siguruar financim të mjaftueshëm nga tregu (rreziku i likuiditetit nga financimi), ose për shkak të vështirësive që lidhen me konvertimin e pozicionit në aktive financiare pa ndikuar negativisht dhe në mënyrë të rëndësishme çmimet, për shkak të kushteve të papërshtatshme ose çrregullimeve të përkohshme të tregut.

Menaxhimi i rrezikut të likuiditetit

Përqasja e Bankës për të administruar likuiditetin është të sigurojë, sa më gjatë të jetë e mundur, të ketë gjithnjë likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e saj në kohë, si në kushte normale dhe në kushte të vështira, pa pësuar humbje të papranueshme apo dëmtuar reputacionin e saj.

- Menaxhimi i procesit të likuiditetit të Bankës përfshin:
- Financimin e përditshëm, të menaxhuar nga monitorimi i flukseve të ardhshme të mjeteve monetare për të siguruar përmbushjen e kërkesave. Kjo përfshin rivendosjen e fondeve në kohën që maturohen ose merren hua nga klientët;
- Mbajtjen e një portofoli aktivesh likuide dhe të tregtueshme;
- Monitorimin e raporteve të likuiditetit të bilancit ndaj kërkesave të brendshme dhe rregullatore;
- Menaxhimin e përqendrimit dhe profilizimin e borxheve të maturuara.

Përgjegjësia për administrimin e situatës së përditshme të likuiditetit mbetet nën monitorimin e Sektorit të Thesarit. Raportet e përditshme dhe shkëmbimi i informacioneve ndërmjet funksioneve të ndryshme të Bankës mbulojnë flukset monetare të vlerësuara për ditën, javën, dhe muajin pasues që konsiderohen si periudha kyçe të menaxhimit të likuiditetit. Pikënisja e projekteve është analiza e maturitetit kontraktual të detyrimeve financiare dhe data e pritshme e mbledhjes për aktivet financiare. Menaxhimi i likuiditetit për periudhat afatshkurtra dhe afatmesme është në përgjegjësinë e ALCO-s. ALCO analizon në baza mujore situatën e likuiditetit të Bankës dhe propozon veprimet që konsiderohen si të nevojshme.

Elementi kyç i përdorur nga Banka për administrimin e rrezikut të likuiditetit është raporti i aktiveve likuide mbi detyrimet afatshkurtra dhe hendeuku kumulativ deri në 3 muaj. Për këtë qëllim aktivet likuide konsiderohen mjetet monetare dhe ekuivalentët me to si dhe portofoli i letrave me vlerë të vlefshme për shitje. Raportet e likuiditetit të përcaktuara nga Banka janë në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë të vendosura nga Rregullorja "Mbi administrimin e rrezikut të likuiditetit".

Banka përlogarit mbi baza ditore dhe mujore raportet e mëposhtme: aktivet likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra, huatë ndaj depozitave dhe aktivet likuide ndaj depozitave. Aktivet likuide konsiderohen mjetet monetare dhe ekuivalentët me to, bonot e thesarit të qeverisë Shqiptare dhe çdo depozitë afatshkurter me bankat të cilat maturohen brenda 7 ditëve.

Detaje të raportit të aktiveve likuide ndaj detyrimeve afatshkurtra gjatë periudhës raportuese ka qenë si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Mesatarja për periudhën	56.96%	58.10%
Minimumi për periudhën	44.99%	44.26%
Maksimumi për periudhën	68.79%	70.48%